

20101152225

L I G J
PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT
E PËRAFËRTA

KAPITULLI I PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

PJESA 1
DISPOZITA HYRËSE

Lënda e ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen e drejta e autorit mbi veprat e tij autoriale (në tekstin e mëtejshëm: e drejta e autorit), të drejtat e artistëve-realizuesve, të prodhuesve të fonogrameve, të prodhuesve të videogrameve (producentëve filmikë), të organizatave radiotelevizive, të botuesve dhe të përpiluesve të bazave të të dhënave mbi lëndët e tyre të të drejtave të përafërta (në tekstin e mëtejshëm: të drejta të përafërta), realizimi dhe mbrojtja e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta dhe vlefshmëria e ligjit.

Transparenca, botimi, lëshimi

Neni 2

(1) Transparenca, sipas këtij ligji, paraqet qasje në veprën e autorit, përkatësisht në lëndët e të drejtave të përafërta, në kushte të njëjta, të një numri më të madh të personave jashtë rrethit më të ngushtë të familjarëve dhe të të njohurve personalë.

(2) Vepra autoriale dhe lëndët e të drejtave të përafërta konsiderohen të botuara, nëse janë bërë të arritshme për publikun, në pajtim me bartësit e të drejtave, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Vepra autoriale dhe lëndët e të drejtave të përafërta konsiderohen të botuara, nëse në pajtim me bartësit e të drejtave janë të përpiluara në numër të mjaftueshëm të ekzemplarëve të ofruara publikut dhe qarkullimi i tyre.

Kompensimi i drejtë

Neni 3

Autori, përkatësisht bartësi i të drejtës së përafërt, ka të drejtë në kompensim të drejtë për çdo lloj shfrytëzimi të veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtës së përafërt, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Raporti ndërmjet të drejtës së autorit dhe
të drejtave të përafërta

Neni 4

Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të përafërta, sipas këtij ligji, nuk e cenon dhe në asnjë mënyrë nuk ndikon në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit.

Përjashtime dhe kufizime

Neni 5

Me këtë ligj mund të përcaktohen raste të veçanta dhe kushte për përjashtime dhe kufizime gjatë shfrytëzimit të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.

PJESA 2
RAPORTI NDËRMJET TË DREJTËS SË AUTORIT
DHE TË DREJTËS PRONËSORE

Dispozita e përgjithshme

Neni 6

E drejta e autorit është e drejtë e mëvetësishme dhe e pavarur nga e drejta pronësore ose të drejtat tjera mbi lëndë/sendë në të cilat është e përmbajtur vepra e autorit, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Ndarja e bartjes

Neni 7

(1) Bartja e të drejtave materiale të autorit të veprës nuk ndikon në të drejtën pronësore të lëndës në të cilën është e përmbajtur vepra e autorit, nëse me ligj ose me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Bartja e të drejtës së autorit nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk ndikon në bartjen e të drejtave materiale të autorit të veprës, nëse me ligj ose me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe.

Prona e përbashkët e bashkëshortëve

Neni 8

Në pronën e përbashkët të bashkëshortëve nuk hyn e drejta e autorit. Në pronën e përbashkët të bashkëshortëve hyn vetëm dobia pronësore e cila del nga shfrytëzimi i të drejtës së autorit.

Përmbarimi mbi të drejtën të autorit

Neni 9

(1) Përmbarimi mbi të drejtën e autorit nuk është i lejuar.

(2) Përmbarimi është i mundshëm vetëm mbi dobinë pronësore e cila del nga e drejta e autorit.

(3) Përmbarimi mbi veprën e papërfunduar të autorit dhe mbi origjinalin e pabotuar të veprës së autorit nuk është i lejuar.

Kufizimi i të drejtës së përpunimit

Neni 10

(1) Nëse pronari i objektit arkitektonik ka për qëllim që atë vepër ta përpunojë, është i obliguar që atë përpunim fillimisht t'ia ofrojë autorit të veprës burimore, nëse i njëjti është i gjallë dhe është i arritshëm në mënyrë të rëndomtë.

(2) Nëse autori pa arsye e refuzon ofertën nga paragrafi (1) i këtij neni, pronari i veprës e fiton të drejtën e përpunimit, por është i obliguar që t'i respektojë të drejtat morale të autorit.

Mbrojtja gjatë zhdukjes së origjinalit

Neni 11

(1) Nëse pronari i origjinalit të veprës autoriale, ka për qëllim që origjinalin ta zhdukë, është i obliguar që origjinalin e atillë t'ia ofrojë autorit, ndërsa ky t'ia kompensojë vlerën e materialit nga i cili është përpunuar origjinali.

(2) Nëse kthimi i veprës së autorit nga paragrafi (1) i këtij neni nuk është i mundur, pronari është i obliguar që në mënyrë përkatëse, t'ia mundësojë autorit përpunimin e ekzemplarit nga origjinali.

(3) Në rast kur vepra e autorit, sipas paragrafit (1) të këtij neni është objekt arkitektonik, autori ka të drejtë që ta fotografojë veprën, t'i mundësohet qasje në vepër për incizim hartografik, përkatësisht në matje të objektit dhe të kërkojë që me shpenzime të tij, t'i dorëzohen kopje nga projektet.

KAPITULLI I DYTË E DREJTA E AUTORIT

PJESA 1 VEPRA AUTORIALE

Nocioni i veprës autoriale

Neni 12

(1) Vepra autoriale, sipas këtij ligji, është krijim intelektual dhe individual nga sfera e letërsisë, shkencës dhe artit, e shprehur në cilëndo mënyrë dhe formë.

(2) Për vepër autoriale konsiderohet veçanërisht:

1) vepra e shkruar (libër, shkrim, artikull, doracak, broshurë, debat dhe vepra tjera të natyrës së njëjtë);

2) programi kompjuterik, si vepër e shkruar;

3) vepra e folur (ligjërim, fjalim, bisedë dhe vepra tjera të natyrës së njëjtë);

4) vepra muzikore, me ose pa tekst;

5) vepra dramatike, dramatike-muzikore, koreografike dhe pantomimike;

6) vepra fotografike dhe vepra e krijuar në procedurë të ngjashme të asaj fotografike;

7) vepra audiovizuale (kinematografike dhe vepër tjetër e shprehur me fotografi lëvizëse);

8) vepra nga arti figurativ (fotografi, vizatim, grafikë, skulpturë dhe të tjera);

9) vepra nga arkitektura;

10) vepra nga arti aplikativ dhe dizajni dhe

11) vepra hartografike, plan, skicë, vizatim teknik, projekt, tabelë, vepër plastike dhe vepër tjetër me karakter të njëjtë ose të ngjashëm nga sfera e gjeografisë, topografisë, arkitekturës dhe shkencës.

(3) Si vepër autoriale konsiderohet edhe përpunimi i veprës autoriale, nëse i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Pjesët përbërëse të veprës autoriale

Neni 13

(1) Pjesa përbërëse e veprës autoriale, si dhe titulli i veprës, nëse vetvetiu paraqet krijim intelektual dhe individual, konsiderohet si vepër autoriale e veçantë.

(2) Nuk është e lejuar si titull i veprës autoriale të shfrytëzohet titulli nga paragrafi (1) i këtij neni që tanimë kanë qenë i përdorur për vepër nga lloji i njëjtë, nëse titulli i atillë do të krijonte huti ose do të sillte krijimin e hutisë në lidhje me veprën autoriale dhe autorin.

Përmbledhje të veprave autoriale

Neni 14

(1) Si vepër autoriale konsiderohet edhe përmbledhja e veprave autoriale, të veprave nga krijimtaria popullore, të të dhënave ose të materialeve tjera, të cilat sipas zgjedhjes dhe renditjes së pjesëve përbërëse paraqesin krijim individual dhe intelektual, siç janë: enciklopedia, antologjia, përmbledhja, përmbledhja muzikore, përmbledhja e fotografive, hartat, ekspozita, ekspozime, përmbledhja e dokumenteve dhe përmbledhje tjera.

(2) E drejta e autorit mbi veprën autoriale nga paragrafi (1) i këtij neni në cilëndo qoftë mënyrë nuk ka të bëjë me përmbajtjen e saj dhe nuk ndikon në të drejtat mbi veprën e cila është pjesë përbërëse e përmbledhjes.

Baza e të dhënave

Neni 15

(1) Baza e të dhënave është vepër autoriale.

(2) Baza e të dhënave sipas paragrafit (1) të këtij neni është përmbledhje e të dhënave, nëse është e rregulluar sipas sistemit ose metodës së caktuar, elementeve të së cilës mund t'u qaset individualisht nëpërmjet mjeteve elektronike ose të tjera.

(3) E drejta e autorit mbi bazën e të dhënave nuk ka të bëjë me programet kompjuterike të cilat janë të shfrytëzuara për përpunimin ose punën e bazës së të dhënave me qasje elektronike.

Krijime të pambrojtura

Neni 16

Si vepër autoriale, sipas këtij ligji, nuk konsiderohen:

1) idetë, teoritë, konceptet, metodologjitë e punës ose konceptet matematikore, pavarësisht nga mënyra e shpjegimit ose shprehjeve;

2) tekstet zyrtare të natyrës politike, ligjvënëse, administrative dhe gjyqësore dhe përkthimet e tyre zyrtare;

3) lajmet ditore dhe të tjera të cilat kanë karakter të informatave të thjeshta-mediale, fakte të thjeshta dhe të dhëna dhe

4) idetë dhe konceptet që paraqesin bazë për cilindo qoftë element të programit kompjuterik, duke i përfshirë edhe pjesët e programit që mundësojnë lidhje dhe interaksion ndërmjet elementeve të pajisjes programore dhe makinerike (interfejsave).

PJESA 2

AUTORI

Nocioni i autorit

Neni 17

(1) Autor, sipas këtij ligji, është personi fizik i cili e ka krijuar veprën autoriale.

(2) Autorit i takon e drejta e autorit mbi veprën e tij autoriale me vet krijimin e veprës.

Prezumcioni i autorësisë

Neni 18

(1) Si autor konsiderohet personi emri, pseudonimi, kodi ose shenja tjetër e të cilit, në mënyrë të zakonshme është shënuar në vepër, përkatësisht ekzemplarët e saj, ose është shënuar gjatë botimit të veprës, derisa nuk dëshmohet e kundërta, në pajtim me këtë ligj.

(2) Në rast kur autori nuk është i njohur, as nuk mundet të përcaktohet sipas dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni, të drejtën e autorit e realizon personi i cili në mënyrë ligjore e ka botuar veprën autoriale.

(3) Dispozita nga paragrafi (2) i këtij neni, ndërpritet të zbatohet kur identiteti i autorit do të përcaktohet. Në këtë rast, personi nga paragrafi (2) i këtij neni, është i obliguar që dobinë pronësore të fituar nga realizimi i veprës autoriale t'ia dorëzojë autorit, nëse me marrëveshje ndërmjet tyre nuk është përcaktuar ndryshe.

Bashkautorët

Neni 19

(1) E drejta e autorit e veprës së krijuar në bashkëpunim të dy ose më shumë personave, u takon të gjithë atyre personave (bashkautorëve).

(2) Për çdo shfrytëzim të veprës nga paragrafi (1) i këtij neni, është i nevojshëm pëlqimi nga çdo bashkautor. Bashkautor i veçantë nuk mund të refuzojë që të japë pëlqim, për arsye se janë në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë.

(3) Kur vepra e krijuar nga bashkautorë përbëhet nga pjesë të pavarura (tërësi e ndashme), secili nga bashkautorët mund të lejojë shfrytëzim të pavarur të pjesës së tij, me kusht që shfrytëzimi i atillë të mos jetë në dëm të shfrytëzimit të veprës së përbashkët, përkatësisht të të drejtave të bashkautorëve tjerë.

(4) Pjesëmarrja e bashkautorëve të veçantë në kompensim të realizuar nga shfrytëzimi i veprës, përcaktohet në përpjesëtim me kontributin e vërtetë që secili prej tyre e ka pasur edhe gjatë krijimit të veprës, nëse ndërmjet bashkautorëve nuk është marrë vesh ndryshe.

(5) Në rast kur nuk mund të përcaktohet kontributi i vërtetë nga paragrafi (4) i këtij neni, ose nuk është arritur marrëveshje ndërmjet bashkautorëve, secilit nga bashkautorëve u takon pjesë e barabartë nga kompensimi.

PJESA 3 PËRMBAJTJA E TË DREJTËS SË AUTORIT

Dispozita e përgjithshme

Neni 20

(1) E drejta e autorit është e drejtë unike dhe është e pandashme nga vepra autoriale.

(2) E drejta e autorit përmban të drejta morale ekskluzive, të drejta materiale ekskluzive dhe të drejta tjera, të përcaktuara me këtë ligj.

NDARJA 1. Të drejtat morale

Përmbajtja e të drejtave morale

Neni 21

(1) Të drejtat morale e mbrojnë autorin lidhur me lidhshmërinë e tij personale dhe shpirtërore (intelektuale) me veprën.

(2) Autori i ka të drejtat morale ekskluzive si vijojnë:

- 1) të drejtën e pranimi të autorësisë;
- 2) të drejtën e botimit të parë;
- 3) të drejtën e mbrojtjes së integritetit të veprës dhe
- 4) të drejtën e dorëheqjes.

(3) Autori nuk mund të heq dorë nga të drejtat nga paragrafi (2) i këtij neni.

E drejta e pranimi të autorësisë

Neni 22

(1) Autori ka të drejtë për pranimin e autorësisë së tij mbi veprën.

(2) Autori ka të drejtë që emri i tij, pseudonimi ose shenja tepër, të shënohet në çdo ekzemplar të veprës, përkatësisht të shënohet gjatë çdo shfrytëzimi publik të veprës, përveç nëse autori, me shkrim në mënyrë të prerë nuk deklaron se nuk dëshiron që autorësia e tij të shënohet, ose nëse, gjatë shfrytëzimit, kjo është teknikisht e pamundur ose e papërshtatshme.

E drejta e botimit të parë

Neni 23

(1) Autori ka të drejtë për botim të parë të veprës së tij autoriale dhe në përcaktimin e kushteve për botimin e tij.

(2) Deri në botimin e parë të veprës autoriale, vetëm autori ka të drejtë që publikisht ta paraqesë përmbajtjen ose përshkrimin e veprës së tij.

E drejta e mbrojtjes së integritetit të veprës

Neni 24

Autori ka të drejtë ta kundërshtojë ndryshimin, deformimin ose gjymtimin e veprës e cila mund ta dëmtojë personalitetin, nderin dhe autoritetin e tij, si dhe prishjen e veprës.

E drejta e dorëheqjes

Neni 25

(1) Autori ka të drejtë që t'ia heqë të drejtën e shfrytëzimit të veprës bartësit të së drejtës së tij materiale, nëse shfrytëzimi i mëtejshëm mund ta dëmtojë personalitetin, nderin dhe autoritetin e tij.

(2) Nëse autori ia heq të drejtën e shfrytëzimit të veprës nga paragrafi (1) i këtij neni, është i obliguar që bartësit t'ia kompensojë dëmin që ajo heqje e ka shkaktuar.

(3) Bartësi i të drejtës nga paragrafi (1) i këtij neni, është i obliguar që në afat prej tre muajsh nga pranimi i heqjes, t'ia kumtojë autorit lartësinë e dëmit që duhet të kompensohet. Nëse këtë nuk e bën, pas skadimit të afatit heqja bëhet e plotfuqishme.

(4) Me heqjen nga e drejta nga paragrafi (1) i këtij neni, e drejta materiale i kthehet autorit.

(5) Nëse autori dëshiron që përsëri ta bartë të drejtën materiale të veprës së tij, ai është i obliguar që atë bartje fillimisht dhe në kushte të njëjta t'ia ofrojë bartësit të së drejtës nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Dispozitat e këtij neni nuk kanë të bëjnë me programin kompjuterik, veprën audiovizuale dhe bazat elektronike të të dhënave.

NDARJA 2. Të drejtat materiale

Përmbajtja e të drejtave materiale

Neni 26

(1) Të drejtat materiale i mbrojnë interesat pronësore të autorit nga vepra e tij autoriale.

(2) Autori ka të drejtë ekskluzive që ta lejojë ose ndalojë shfrytëzimin e veprës së tij, ose ekzemplarë të tij nga persona tjerë, përveç në rastet e përcaktuara me këtë ligj.

Llojet e të drejtave materiale

Neni 27

Autori gjatë shfrytëzimit të veprës autoriale apo të ekzemplarëve të ti, i ka të drejtat materiale ekskluzive si vijojnë:

- 1) të drejtën e shumëzimit të veprës;
- 2) të drejtën e lëshimit në qarkullim të veprës;
- 3) të drejtën e paraqitjes publike të veprës dhe
- 4) të drejtën e përpunimit të veprës.

Shumëzimi

Neni 28

(1) Shumëzimi sipas këtij ligji është regjistrim, përkatësisht incizim i veprës autoriale në bazë materiale apo bazën tjetër përkatëse (elektronike etj.), si dhe përpunimi i një apo më tepër ekzemplarëve të veprës në tërësi apo në pjesë, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, përkohësisht apo përherë, me çfarëdo qoftë mjeteshe dhe në çfarëdo qoftë forme.

(2) Shumëzimi nga paragrafi (1) i këtij nen, kryhet kryesisht me: procedura grafike (shumëzim grafik), shumëzim tredimensional, fotokopim dhe me procedura tjera fotografike me të cilat arrihet efekti i njëjtë, ndërtim, përkatësisht realizim të veprave nga arkitektura, incizim tonik apo incizimin vizuel, depozitimi të veprës në formë elektronike (regjistrim elektronik) dhe me bartjen e veprës nga sistemi analog në sistemin digjital.

Lëshimi në qarkullim

Neni 29

(1) Lëshimi në qarkullim sipas këtij ligji, është ofrimi publikut për shitje apo ndonjë formë tjetër të bartjes së të drejtës së pronësisë apo të drejtës së shfrytëzimit të origjinalit apo të ekzemplarëve të veprës, duke e përfshirë importimin dhe huazimin, ndërsa e përfshin edhe të drejtën e kompensimit nga shërbimi, të përcaktuar me këtë ligj.

(2) Importi, sipas këtij ligji, është futja në tregun vendor të origjinaleve apo të ekzemplarëve të veprës autoriale për qarkullim të mëtutjeshëm, për qëllim komercial.

(3) Huazimi, sipas këtij ligji, është dhënia për shfrytëzim e origjinalit apo ekzemplarit të veprës autoriale në kohë të caktuar, për shkak të dobisë pronësore të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Huazimi nuk ka të bëjë me vepra të ndërtuara arkitekturore dhe të origjinaleve dhe ekzemplarëve të veprave nga arti i aplikuar dhe dizajni.

(4) Shërbimi, sipas këtij ligji, është dhënia për shfrytëzim e veprës autoriale në kohë të caktuar, pa realizim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë pronësore nëpërmjet organizatave në të cilat publiku ka qasje.

(5) E drejta e lëshimit në qarkullim në territorin e Republikës së Maqedonisë, përfundon me të shitjen e parë apo me formë tjetër të bartjes së të drejtës së pronësisë të origjinalit apo ekzemplarit të veprës autoriale, që kryhet nga ana e bartësit të së drejtës apo me pëlqimin e tij. Përfundimi nuk ka të bëjë me të drejtën e importit, të huazimit dhe të shërbimit.

Kumtimi publik

Neni 30

Kumtimi publik i veprës sipas këtij ligji, është:

- 1) realizimi publik;
- 2) transmetimi publik;
- 3) ekspozimi publik;
- 4) paraqitja publike;
- 5) transmetimi radiodifuziv;
- 6) ritransmetimi dhe
- 7) vënia në disponim publikut.

Realizimi publik

Neni 31

Realizimi publik sipas këtij ligji, është:

- 1) të folurit apo recitimi i drejtpërdrejtë i veprave nga fusha e letërsisë;
- 2) realizimi i drejtpërdrejtë i veprave muzikore dhe
- 3) realizimi skenik apo shfaqja e drejtpërdrejtë e veprave dramatike, dramatike-muzikore, koreografike dhe pantomimike.

Transmetimi publik

Neni 32

Transmetimi publik, sipas këtij ligji, është kumtimi publik nëpërmjet altoparlantit, ekranit dhe cilitdo qoftë mjet tjetër teknik të:

- 1) realizimit të veprës autoriale drejtpërdrejt, jashtë hapësirës apo vendit në të cilin vepra realizohet drejtpërdrejt;
- 2) incizimit tonik dhe/ose vizuel të veprës autoriale (fonograme, videograme etj.) nga baza në të cilën është e incizuar dhe
- 3) veprës autoriale që në mënyrë radiodifuzive transmetohet.

Ekspozimi publik

Neni 33

Ekspozimi publik, sipas këtij ligji, është prezantimi publikut: i origjinalit apo të ekzemplarit të veprës nga arti figurativ, i veprës fotografike apo të veprës së krijuar në procedurë të ngjashme me atë fotografike, të veprës nga fusha e artit aplikativ, dizajnit, arkitekturës, urbanizmit, hartografisë, si dhe veprës tjetër të natyrës shkencore dhe teknike.

Paraqitja publike

Neni 34

Paraqitja publike, sipas këtij ligji, është prezantimi publikut, nëpërmjet mjeteve teknike, i veprës audiovizuele apo të veprës nga fusha e fotografisë, artit figurativ, arkitekturës, urbanizmit, artit të aplikuar, dizajnit, hartografisë, si dhe veprave të natyrës shkencore dhe teknike.

Transmetimi radiodifuziv

Neni 35

(1) Transmetim radiodifuziv, sipas këtij ligji, është kumtimi i veprës autoriale nëpërmjet sinjaleve programore të radios dhe të televizionit të dedikuara për pranim nga publiku, pa tela, duke përfshirë sistemin satelitor apo sistemin me tela, duke përfshirë sistemin kabllovik, me mikrovalë dhe sistem tjetër.

(2) Me satelit, sipas këtij ligji, nënkuptohet cilido qoftë satelit që punon në frekuencën e cila në pajtim me rregullat për telekomunikime, është rezervuar për emitim të sinjaleve të dedikuara për pranim nga publiku apo për komunikim të mbyllur individual, me ç'rast, kushtet e pranimi të sinjaleve duhet të jenë përkatëse me kushtet e pranimi nga ana e publikut.

(3) Transmetimi radiodifuziv nëpërmjet satelitit, kryhet kur nën kontroll dhe përgjegjësi të organizatës radiotelevizive dërgohen sinjale për emitim të programit të dedikuar për publikun, në zinxhir të pandërprerë komunikues që shpie te sateliti dhe prej satelitit kah toka.

(4) Kur sinjalet programore janë të koduara, emitimi radiodifuziv nëpërmjet satelitit konsiderohet si i kryer, nëse nëpërmjet organizatës radiodifuzive apo nëpërmjet personit tjetër, me pajtim të saj, mjetet për dekodim janë të arritshme për publikun.

Ritransmetimi

Neni 36

Ritransmetimi, sipas këtij ligji, është njëkohësisht, transmetimi në tërësi dhe i pandryshuar i transmetimit radiodifuziv të veprës autoriale, nëse:

1) e kryen organizata tjetër radiotelevizive, e jo ajo që veprën fillimisht e transmeton (në tekstin e mëtejshëm: ritransmetimi radiodifuziv) dhe

2) transmetohet nëpërmjet sistemit kabllovik apo sistemit me mikrovalë, kurse fillimisht e transmeton organizata radiodifuzive pa tela apo me tela (në tekstin e mëtejshëm: ritransmetimi kabllovik).

Vënia në disponim për publikun

Neni 37

Vënia në disponim për publikun sipas këtij ligji, është vepra autoriale t'i kumtohet publikut, në formë të lidhjes pa tela apo me tela, duke përfshirë internetin apo rrjete tjera komunikuese, në mënyrë që çdokujt i mundëson qasje në vepër, nga vendi dhe në kohë që vetë e zgjedh.

Përpunimi

Neni 38

(1) Përpunimi, sipas këtij ligji, është përkthimi, përshtatja, duke e përfshirë edhe përshtatjen audiovizuele, aranzhmanin muzikor dhe ndryshimin tjetër të veprës autoriale dhe të veprës nga krijimtaria popullore, si dhe të materialeve tjera të shkruara, siç janë përkthimet e teksteve zyrtare të cilat nuk janë të bëra për shfrytëzim zyrtar.

(2) Të drejtat mbi veprën autoriale të krijuar me përpunim, nuk ndikojnë në cilëndo qoftë mënyrë në të drejtat mbi veprën që është e përpunuar.

NDARJA 3. Të drejtat tjera të autorit

Përmbajtja e të drejtave tjera të autorit

Neni 39

Të drejta tjera të autorit janë:

- 1) e drejta e qasjes dhe e dorëzimit;
- 2) e drejta e vijimësisë (e drejta e kompensimit nga rishitja);
- 3) e drejta e kompensimit nga shumëzimi për shfrytëzim privat;
- 4) e drejta e kompensimit nga huazimi dhe
- 5) e drejta e kompensimit nga shërbimi;

Nëndarja 1. E drejta e qasjes dhe e dorëzimit

E drejta e qasjes dhe e dorëzimit

Neni 40

(1) Autori ka të drejtë të qasjes në origjinalin apo në ekzemplar in nga vepra e vet që e posedon tjetri, për realizimin e së drejtës së shumëzimit apo të drejtës së përpunimit të veprës, nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesin e arsyeshëm të poseduesit.

(2) Autori ka të drejtë të kërkojë që poseduesi t'ia dorëzojë origjinalin e veprës figurative apo të veprës fotografike për ekspozim publik, apo formë tjetër të publikimit, nëse për këtë ekziston interes i arsyeshëm.

(3) Dorëzimi i origjinalit nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të kushtëzohet me dhënien e kaucionit përkatës apo me sigurim në lartësi të vlerës së tregut të origjinalit.

(4) Autori është i obliguar që qasjen dhe dorëzimin nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, ta kryejë me sa është e mundur më pak telashe për poseduesin dhe me shpenzim të vet. Në rast të dëmtimit të veprës, përgjegjës është autori, pavarësisht nga faji i tij.

Nëndarja 2. E drejta e vijimësisë (e drejta e kompensimit nga rishitja)

E drejta e vijimësisë së veprës artistike origjinale

Neni 41

(1) Autori ka të drejtë që të informohet dhe të marrë kompensim nga çdo shitje e ardhshme apo tëhuajësimi në ndonjë mënyrë tjetër të origjinalit të veprës artistike, të përcaktuar me këtë ligj (në tekstin e mëtejshëm: e drejta e vijimësisë).

(2) E drejta e vijimësisë nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk mund të jetë lëndë e dorëheqjes, posedimit dhe përmbartimit mbi të drejtën e autorit.

Origjinali i veprës artistike

Neni 42

(1) Origjinali i veprës artistike sipas nenit 41 të këtij ligji, është vepër nga arti figurativ, grafik apo plastik, siç janë: pikturat, kolazhet, vizatimet, grafikët, gravurat, litografitë, skulpturat, qeramikat, gdhendjet, tapiceritë, veprat në qelq, vepra fotografike dhe vepra e krijuar në procedurë të ngjashme me atë fotografike, si dhe ekzemplarë të veprave të theksuara që konsiderohen si origjinale.

(2) Ekzemplarë të veprave të theksuara që i ka krijuar vetë autori apo janë bërë me leje të tij në një numër të kufizuar, do të konsiderohen si origjinale. Ato zakonisht doemos duhet, nga autori, të numërtohen, nënshkruhen apo në ndonjë mënyrë tjetër përkatëse të shënohen.

Shuma që i përket autorit

Neni 43

(1) Kompensimi i autorit nga e drejta e vijimësisë, përcaktohet sipas shkallëve si vijojnë:

- 1) 5% për pjesën nga çmimi i shitjes prej 300 deri në 3 000 euro;
- 2) 4% për pjesën nga çmimi i shitjes prej 3 000,01 deri në 50 000 euro;
- 3) 3% për pjesën nga çmimi i shitjes prej 50 000,01 deri në 200 000 euro;
- 4) 1% për pjesën nga çmimi i shitjes prej 200 000,01 deri në 350 000 euro;
- 5) 0,5% për pjesën nga çmimi i shitjes prej 350 000,01 deri në 500 000 euro dhe
- 6) 0,25% për pjesën nga çmimi i shitjes mbi 500 000 euro.

(2) Shuma më e lartë e kompensimit nuk guxon të tejkalojë 12 500 euro.

(3) Kompensimin e autorit nga paragrafi (1) i këtij neni, në mënyrë solidare e paguan shitësi i veprave artistike, galeristi, organizatori i shitjes publike apo ndërmjetësuesi tjetër që e kryen shitjen e veprave artistike.

(4) Kompensimet nga ky nen llogariten në kundërvlerë me denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e shitjes. Baza për llogaritje është çmimi i shitjes, pa tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).

E drejta e vijimësisë së dorëshkrimit

Neni 44

(1) Nëse origjinali (dorëshkrimi) i veprës letrare apo muzikore është i shitur apo në mënyrë tjetër i tëhuajësuar, autori i tij ka të drejtë që të jetë i njoftuar për çdo shitje të ardhshme dhe për çdonjërën prej tyre të marrë kompensim në shumën neto prej 3% nga secili çmim i shitjes.

(2) Dispozitat nga neni 43 paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe për veprat nga paragrafi (1) i këtij neni.

E drejta e informatave

Neni 45

Autori, trashëgimtarët apo organizatat për menaxhim kolektiv të së drejtës së autorit, kanë të drejtë që në afat prej tre vitesh nga dita e shitjes së veprës së autorit, nga subjektet nga nenet 43 paragrafi (3) dhe 44 të këtij ligji, t'i kërkojnë të gjitha informatat e domosdoshme për arkëtimin e kompensimit nga rishitja, e kryesisht: për titujt e veprave të tjetërsuara, për pronarin dhe ndërmjetësuesin, për marrëveshjet për shitje dhe për çmimin e shitjes.

Nënndarja 3. E drejta e kompensimit nga shumëzimi për shfrytëzim privat

E drejta e kompensimit

Neni 46

(1) Për shumëzim për shfrytëzim privat paguhet kompensim.

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni, për shumëzim të fonogrameve dhe videogrameve paguhet gjatë shitjes së parë apo importit të mjeteve për incizim tonik dhe vizuel dhe të bartësve të rinj të païncizuar të tonit dhe të tonit dhe fotografisë.

(3) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni, për fotokopjim paguhet gjatë shitjes së parë apo importit të mjeteve për fotokopjim dhe nga përpunimi i fotokopjeve, të dedikuara për shitje mujore, në pajtim me numrin e mundshëm të fotokopjeve.

(4) Me mjetet për incizim tonik dhe vizuel janë unifikuar të gjitha mjetet e tjera të cilat mundësojnë që të arrihet efekti i njëjtë, kurse me fotokopjim janë unifikuar edhe teknikat tjera për shumëzim.

(5) Autori ka të drejtë të pjesës nga kompensimi unik nga paragrafi (1) i këtij neni, për shumëzimin e fonogrameve dhe videogrameve dhe nga fotokopjimi i veprës së tij që kryhet për shfrytëzim privat.

(6) E drejta e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij nen, nuk mund të jetë lëndë e dorëheqjes, posedimit apo përmbarimit mbi të drejtën e autorit.

Subjektet e obliguara që të paguajnë

Neni 47

(1) Obligim për pagesë të kompensimit nga neni 46 i këtij ligji, kanë prodhuesit dhe importuesit e mjeteve për incizim tonik dhe vizuel, të mjeteve për fotokopjim, të bartësve të paincizuar të tonit dhe të tonit dhe fotografisë, si dhe personat që kryejnë shërbime të fotokopjimit.

(2) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar që me kërkesë të organizatës kompetente për menaxhim kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, t'ia dorëzojnë të dhëna për llojin dhe numrin e mjeteve të shitura apo të importuara dhe bartësve të tonit dhe të tonit dhe fotografisë, si dhe të dhëna për fotokopjet e bëra.

Lartësia e kompensimit

Neni 48

(1) Lartësinë e kompensimit nga neni 46 të këtij ligji, e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohet posaçërisht për çdo lloj të mjetit për incizim tonik dhe vizuel, për çdo mjet për incizim, për të cilin për shkak të konstruksionit të vet nuk është i nevojshëm material i posaçëm për punën e vet (në shumën e dyfishuar nga e zakonshmja), për çdo bartës të tonit dhe të tonit dhe fotografisë në bazë të kohëzgjatjes së tij të incizimit, për çdo mjet për fotokopjim në bazë të numrit të mundshëm të fotokopjimit në minutë dhe në bazë të mundësisë për fotokopjim me ngjyrë (në shumën e dyfishuar nga fotokopjimi bardhë e zi), si dhe për çdo fotokopje të veçantë të dedikuar për shitje.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë i harmonizon shumat e kompensimeve nga paragrafi (1) të këtij neni, varësisht me lëvizjen e çmimeve dhe shpenzimet e jetesës në Republikën e Maqedonisë.

Nënndarja 4. E drejta e kompensimit nga huazimi

E drejta e kompensimit

Neni 49

(1) Autori, i cili të drejtën e vet të huazimit, në pajtim me nenet 72 dhe 91 paragrafi (2) të këtij ligji, ia ka bartur prodhuesit të fonogramit apo prodhuesit të videogramit (në tekstin e mëtejshëm: producenti filmik), e mban të drejtën e kompensimit për çdo huazim të veprës.

(2) Autori nuk mund të heq dorë nga e drejta e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni.

Nënndarja 5. E drejta e kompensimit nga shërbimi

E drejta e kompensimit

Neni 50

(1) Autori ka të drejtë kompensimi nga shërbimi i origjinalit apo ekzemplarëve të veprës së tij autoriale.

(2) E drejta e shërbimit nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk ka të bëjë me objektet arkitektonike, veprat nga arti aplikativ dhe dizajni, si dhe veprat që reciprokisht i huazojnë organizatat nga paragrafi (4) i këtij neni.

(3) Kompensimin nga paragrafi (1) i këtij neni, e paguan organizata që e kryen shërbimin.

(4) Nga obligimi për pagesë të kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni, përjashtohen institucionet publike nga fusha e shkencës, kulturës dhe arsimit (bibliotekat, kinotekat, institucionet shkencore dhe arsimore).

(5) Autori nuk mund të heq dorë nga e drejta e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni.

PJESA 4 PËRJASHTIME DHE KUFIZIME

Dispozita të përgjithshme

Neni 51

(1) Vepra autoriale mund të shfrytëzohet pa leje të autorit me apo pa kompensim, vetëm nëse vepra është e botuar.

(2) Shfrytëzimi nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të bëhet vetëm në raste të posaçme, nëse nuk bie ndesh me shfrytëzimin normal të veprës dhe nëse në mënyrë të paarsyeshme nuk i cenon interesat legjitime të autorit.

(3) Dispozitat nga kjo Pjesë nuk zbatohen për programin kompjuterik.

Shfrytëzimi pa pagesën e kompensimit

Neni 52

(1) Shfrytëzimi i veprës së autorit pa pagesën e kompensimit, ka të bëjë me rastet si vijojnë:

1) shumëzimin e përkohshëm të veprës autoriale, kur shumëzimi është me karakter kalimtar apo të rastësishëm, dhe/ose është pjesë përbërëse dhe thelbësore e procesit teknologjik, nëse shumëzimi vetvetiu nuk ka vlefshmëri ekonomike të pavarur dhe qëllimi i vetëm i shumëzimit të së cilës është që të mundësojë bartje të të dhënave në rrjet ndërmjet personave të tretë nëpërmjet ndërmjetësuesit, apo të mundësojë shfrytëzim ligjor të veprës;

2) shumëzimin që bëhet nga ana e bibliotekave publike, institucioneve arsimore apo muzeve dhe arkivave për shkak të realizimit të veprimtarisë së tyre dhe pa qëllim ekonomik apo komercial të drejtpërdrejtë apo të tërthortë;

3) incizimin e veprës autoriale nga ana e organizatës radiotelevizive që ka leje për emitim të veprës, nëse e incizon me mjete personale dhe për nevoja personale dhe me kusht që ta shlyejë në afat në të cilin e ka lejen për emitim. Nëse incizimi ka vlerë të posaçme dokumentuese mund të dorëzohet dhe ruhet në arkivin publik;

4) shfrytëzimin e veprave për shkak të ilustrimit në hulumtimet arsimore apo shkencore deri në shkallë të arsyeshme me qëllim jokomercial që duhet të arrihet, me kusht që të shënohet emri i autorit dhe burimi, përveç nëse kjo është e pamundur;

5) shfrytëzimin e veprave autoriale për nevojat e personave me nevoja të posaçme, në mënyrë që është e lidhur drejtpërdrejt me nevojën e posaçme, deri në shkallë që atë e kërkon edhe pa qëllim komercial;

6) shumëzimin dhe kumtimin publik t'i shkrimeve, artikujve dhe veprave të tjera të ngjashme për tema aktuale ekonomike, politike, religjioze dhe të tjera të ngjashme, për shkak të njoftimit të publikut, deri në shkallë të arsyeshme me qëllimin, përveç nëse kjo nuk është e ndaluar posaçërisht nga ana e autorit me kusht që të shënohet emri i autorit dhe burimi, përveç nëse kjo është e pamundur;

7) shfrytëzimin e pjesëve të veprave autoriale (citateve), në hulumtime shkencore, për mësim, kritikë, polemikë apo kontroll, në vëllim dhe deri në shkallë të nevojshme për dedikimin konkret dhe me kusht që të shënohet emri i autorit dhe burimi, përveç nëse kjo është e pamundur;

8) shfrytëzimin e veprave për qëllime të sigurisë publike apo në procedurë gjyqësore, parlamentare apo administrative;

9) shfrytëzimin e fjalimeve politike, si dhe ekstrakteve nga ligjëratat publike dhe veprat e ngjashme deri në shkallë të arsyetuar me dedikim informativ, me kusht që të shënohet emri i autorit dhe burimi, përveç nëse kjo është e pamundur;

10) shfrytëzimin e veprave gjatë kohës së riteve fetare apo shënimeve tjera zyrtare të organizuara nga organet e pushtetit shtetëror dhe njësit e vetadministrimit lokal;

11) shfrytëzimin e veprave arkitektonike dhe të skulpturës të vendosura në mënyrë permanente në vende publike (rrugë, sheshe, parqe etj.);

12) shfrytëzimin e veprave nga fusha e artit figurativ dhe aplikativ, arkitekturës, dizajnit industrial dhe veprave fotografike të ekspozuara në ekspozita publike apo në ankand, nga ana e organizatorit, në pllakate apo katalogë të përpunuara pa qëllime komerciale, deri në shkallë të domosdoshme për promovimin e ngjarjes;

13) përpunimin e veprës në parodi, karikaturë apo imitim, me kusht që përpunimi të mos krijojë huti në lidhje me origjinalin e veprës dhe autorësinë dhe nëse përpunimi është në suaza të shfrytëzimit të lejuar të veprës;

14) shumëzimin e veprës autoriale të bartësit të tonit dhe të fotografisë, kumtimin publik të veprës nga ai bartës, si dhe kumtimin publik të veprës që emitohet, në shitoret, në panaiet dhe në vendet tjera ku demonstrohet puna e aparateve për incizim, shumëzimi dhe transmetimi i tonit dhe fotografisë, në masë që është e domosdoshme për demonstrim të punës së aparateve. Regjistrimet/incizimet të krijuara në këtë bazë menjëherë shlyhen;

15) përfshirjen e rastësishme (anësore) të veprës autoriale në material tjetër;

16) shfrytëzimin e vizatimeve apo projekteve të objektit arkitektonik, për shkak të rikonstruimit të tij dhe

17) kumtimin publik dhe vënien në disponim për publikun të veprës autoriale për shkak të hulumtimit apo përsosjes personale të vendeve të caktuara në institucionet publike shkencore, kulturore, arsimore dhe të tjera me karakter të ngjashëm, nëse vepra nuk mund të blihet, apo për shfrytëzim të saj nuk është e nevojshme leje, kurse është pjesë nga koleksionet/fondi i institucioneve.

(2) Shfrytëzimi i bazave të të dhënave apo ekzemplarëve të saja nga ana e shfrytëzuesit ligjor është pa pagim të kompensimit, nëse është e domosdoshme për qasje dhe shfrytëzim të zakonshëm të përmbajtjeve të saja përbërëse.

Shfrytëzimi i veprës nga krijimtaria popullore

Neni 53

(1) Shfrytëzimi i veprës nga krijimtaria popullore është pa kompensim.

(2) Krijimtaria popullore shfrytëzohet në mënyrë të denjë, pa gjymtim dhe me kusht që të jetë i shënuar burimi dhe origjina e veprës.

(3) Për realizimin e të drejtave nga paragrafi (2) i këtij neni, është kompetent institucioni publik dhe shkencor - Instituti i folklorit "Marko Cepenkov" - Shkup.

Shfrytëzimi me pagesën e kompensimit

Neni 54

Shfrytëzimi i veprës autoriale me pagesën e kompensimit ka të bëjë me rastet si vijon:

1) shumëzimin në letër apo në bartësit e ngjashëm të regjistrimit nëpërmjet fotokopjimit apo cilësdo qoftë teknike të ngjashme apo procesi tjetër me efekte të ngjashme, me përjashtim të regjistrimeve të notave të veprës muzikore;

2) shumëzimin në cilindro bartës të regjistrimit që e kryen personi fizik për shfrytëzim privat pa qëllim komercial të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

PJESA 5

KOHËZGJATJA E TË DREJTËS SË AUTORIT

Kohëzgjatja e të drejtës së autorit

Neni 55

(1) Të drejtat materiale zgjasin gjatë jetës së autorit dhe 70 vjet pas vdekjes së tij, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Të drejtat morale zgjasin në afate të ndryshme të përcaktuara me këtë ligj.

Llogaritja e afateve në raste të bashkautorësisë

Neni 56

(1) Kur veprën e kanë realizuar më tepër autorë (bashkautorë), afati i kohëzgjatjes nga neni 55 paragrafi (1) i këtij ligji, llogaritet nga vdekja e autorit që ka vdekur i fundit.

(2) Në rast të bashkautorësisë së veprës audiovizuale afati i kohëzgjatjes së mbrojtjes, llogaritet nga vdekja e personit të gjallë të fundit: regjisorit kryesor, autorit të skenarit, autorit të dialogjeve dhe kompozitorit të muzikës së krijuar në mënyrë speciale për shfrytëzim në veprën audiovizuale, pavarësisht nëse me këtë ligj, ai person konsiderohet si autor i veprës audiovizuale.

Kohëzgjatja e mbrojtjes së veprave anonime dhe veprave me pseudonime

Neni 57

(1) E drejta e autorit të veprave anonime dhe të veprave me pseudonime zgjat 70 vite pas botimit ligjor të veprës.

(2) Nëse pseudonimi nuk shpie në huti për atë se kush është autor apo nëse autori, në afatin e theksuar në paragrafin (1) të këtij ligji e zbulon identitetin e vet, zbatohet afati nga neni 55 paragrafi (1) i këtij ligji.

Afate të veçanta për vepra të pabotuara

Neni 58

Kur afati, sipas këtij ligji, nuk rrjedh nga vdekja e autorit apo autorëve, ndërsa vepra nuk ka qenë e botuar në mënyrë ligjore, e drejta e autorit zgjat 70 vite pas krijimit të saj.

Kohëzgjatja e afateve për veprën autoriale të botuar në pjesë

Neni 59

Në rast kur afati i kohëzgjatjes së të drejtës së autorit, sipas këtij ligji, llogaritet sipas botimit ligjor të veprës, e vepra është botuar në vëllime, pjesë, vazhdime, edicione, episode dhe të ngjashme, afati llogaritet veçanërisht për çdo pjesë përbërëse.

Llogaritja e afateve

Neni 60

Afatet e kohëzgjatjes së mbrojtjes së të drejtës së autorit të përcaktuara me këtë ligj, fillojnë të rrjedhin nga 1 janari i vitit që pason pas ndodhjes, që është bazë për llogaritjen e afateve.

Kohëzgjatja e të drejtave morale

Neni 61

(1) E drejta morale për dorëheqje nga neni 25 i këtij ligji, zgjat deri sa autori është gjallë.

(2) Të drejtat morale për pranimin dhe shënimin e autorësisë, dhe për mbrojtjen e integritetit të veprës autoriale nga nenet 22 dhe 24 të këtij ligji, zgjasin edhe pas skadimit të afateve për kohëzgjatje të të drejtave materiale, të përcaktuara me këtë ligj.

(3) Për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave morale të autorit nga nenet 22 dhe 24 të këtij ligji pas vdekjes së tij, krahas trashëgimtarëve, janë kompetent edhe shoqatat përkatëse (profesionale) të autorëve, personat që kanë interes juridik, si dhe Akademia Maqedonase e Shkencave dhe e Arteve.

Pasojat nga skadimi i afateve

Neni 62

Vepra autoriale, pas skadimit të afateve për kohëzgjatjen e të drejtave

PJESA 6

BARTJA E TË DREJTAVE MATERIALE

Dispozita e përgjithshme

Neni 63

(1) Autori mund t'u bart personave tjerë të drejta të veçanta materiale, në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Bartja nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të kryhet me trashëgimi, me marrëveshje me shkrim (ekskluzive dhe joekskluzive) apo në mënyrë tjetër me shkrim (joekskluzive) me leje, deklaratë, pëlqim dhe ngjashëm.

Bartja me trashëgimi

Neni 64

(1) Të drejtat materiale janë lëndë e trashëgimisë.

(2) Trashëgimtarëve të autorit u takojnë të gjitha të drejtat që do t'i takonin autorit.

(3) Për trashëgiminë e të drejtës së autorit, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, zbatohen dispozitat për trashëgimi.

Bartja me marrëveshje

Neni 65

(1) Autori mundet bartjen e të drejtave materiale personave të tjerë, ta kryejë me marrëveshje me shkrim, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Marrëveshja nga paragrafi (1) të këtij neni, e cila nuk është e lidhur me shkrim, nuk prodhon veprim juridik.

(3) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni i përmban kryesisht: llojin e të drejtave që barten, vëllimin e tyre, ekskluzivisht ose joekskluzivisht, territorin për të cilin ka të bëjë bartja e të drejtave, kohëzgjatjen e bartjes dhe kompensimin e autorit.

(4) Dispozitat kontestuese apo të paqarta në marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni, interpretohen në interes të autorit.

Përcaktimi i kompensimit

Neni 66

(1) Kompensimi i autorit përcaktohet sipas parimit të drejtësisë, llojit të veprës, llojit dhe vëllimit të së drejtës së shfrytëzimit që bartet, kohëzgjatjes dhe rrethanave tjera të rëndësishme për shfrytëzimin e tij.

(2) Nëse me shfrytëzimin e veprës autoriale realizohen të hyra, që janë dukshëm më të mëdha nga kompensimi i kontraktuar, autori ka të drejtë që të kërkojë ndryshim të kompensimit të kontraktuar, që do t'i mundësojë pjesëmarrje më të drejtë në të hyrat. Nga kjo e drejtë autori nuk mund të heq dorë.

(3) Në rast kur kompensimi është i kontraktuar, përkatësisht i përcaktuar varësisht nga të hyrat e realizuara nga shfrytëzimi i veprës, shfrytëzuesi i tij është i detyruar që të mbajë libra përkatës apo evidencë tjetër, nga e cila mund të përcaktohet lartësia e të hyrave të realizuara.

(4) Shfrytëzuesi nga paragrafi (3) i këtij neni, është i detyruar që t'i mundësojë bartësit të së drejtës së autorit inspektim në dokumentacionin/evidencën nga paragrafi (3) i këtij neni dhe t'ia dorëzojë raportet e nevojshme për të hyrat e realizuara në afat të arsyeshëm, nëse afati nuk është i përcaktuar me ligj apo marrëveshje.

Pavlefshmëria

Neni 67

E pavlefshme është bartja e:

- 1) të drejtës së autorit, si tërësi;
- 2) të drejtave morale dhe
- 3) llojeve të panjohura të shfrytëzimit të veprës autoriale.

Zbatimi i dispozitave për marrëdhënie obliguese

Neni 68

Në marrëveshjen për bartje të së drejtës materiale, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat për marrëdhëniet obliguese, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Legjitimacioni aktiv

Neni 69

Të drejtat që sipas këtij ligji i takojnë autorit, duke e përfshirë edhe të drejtën e mbrojtjes gjyqësore, i takojnë edhe bartësit tjetër të së drejtës së autorit, në vëllim që me ligj apo me akt tjetër juridik i janë bartur, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Vëllimi i i bartjes (ekskluzive dhe joekskluzive)

Neni 70

(1) Bartja e të drejtës materiale sipas nenit 63 paragrafi (2) të këtij ligji, kryhet në mënyrë ekskluzive apo joekskluzive.

(2) Me bartje ekskluzive të së drejtës materiale, sipas këtij ligji, lejohet që vetëm një person ta shfrytëzojë veprën, me ç'rast nga shfrytëzimi janë të përjashtuar autori dhe cildo qoftë person tjetër.

(3) Me bartjen joekskluzive të së drejtës materiale sipas këtij ligji, lejohet që personi ta shfrytëzojë veprën, me ç'rast nga shfrytëzimi nuk përjashtohen autori apo cildo qoftë person tjetër.

Rregulla e bartjes së veçuar

Neni 71

Bartja e së drejtës materiale të veçantë nuk ndikon në bartjen e të drejtave tjera materiale, nëse me këtë ligj apo me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe.

Prezumpcioni i bartjes së përbashkët

Neni 72

Gjatë bartjes së të drejtës së shumëzimit, konsiderohet se është bartur edhe e drejta për lëshim në qarkullim të ekzemplarëve të asaj vepre, nëse me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe.

Bartja e mëtejshme

Neni 73

(1) Bartësit të cilit i është bartur e drejta materiale e autorit, nuk mundet pa leje të autorit që atë të drejtë më tutje t'ua bartë personave të tjerë, nëse me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Nëse bartja e mëtejshme e të drejtës është pasojë e ndryshimeve statusore të bartësit, nuk nevojitet leje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Nëse bartja e mëtejshme e të drejtës lejohet pa leje të autorit në pajtim me ligjin apo marrëveshjen, për kërkesat e autorit përgjegjësi solidare bartin bartësi paraprak dhe bartësi i ri.

Prishja e bartjes

Neni 74

(1) Autori mund ta prishë marrëveshjen, përkatësisht ta tërheq lejen apo aktin tjetër të shkruar për bartjen e të drejtës materiale, nëse bartësi i të drejtës ekskluzive në masë të pamjaftueshme e shfrytëzon apo aspak nuk e realizon, e për këto arsye interesat e autorit dukshëm dëmtohen.

(2) Autori nuk mund ta bëjë prishjen, përkatësisht tërheqjen nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse nga ai rrjedhin shkaqet për këtë.

(3) Autori mund t'i ofrojë bartësit nga paragrafi (1) i këtij neni, afat plotësues për shfrytëzimin përkatës të së drejtës.

(4) Me prishjen, përkatësisht tërheqjen nga paragrafi (1) i këtij neni, e drejta materiale i kthehet autorit.

(5) Nëse parimi i drejtësisë e imponon këtë, autori është i detyruar që bartësit të së drejtës t'i paguajë kompensim përkatës të dëmit.

(6) Autori nuk mund të heq dorë nga e drejta e prishjes, përkatësisht tërheqjes sipas këtij ligji.

NDARJA 1. Lloje të veçanta të marrëveshjeve autoriale

Nëndarja 1. Marrëveshja për botim

Marrëveshja për botim

Neni 75

(1) Me marrëveshjen për botim autori ia bart botuesit të drejtën e shumëzimit të veprës së tij dhe lëshimin në qarkullim me botim në formë të librit, me numër të mjaftueshëm të ekzemplarëve të dedikuara për publikun (në tekstin e më tutjeshëm: e drejta e botimit), kurse botuesi për këtë i paguan kompensim, e boton veprën dhe i lëshon në qarkullim ekzemplarët e botuar.

(2) E drejta e botimit nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk e përmban të drejtën e botimit të veprës në formë elektronike. Për botimin e veprës në formë elektronike lidhet marrëveshje e veçantë.

(3) Botuesi i cili e ka të drejtën e botimit të veprës në formë libri, në mesin e ofruesve të barabartë, ka të drejtën e përparësisë për botim të veprës në formë elektronike. E drejta e përparësisë zgjat tri vite nga botimi i veprës në formë libri. Botuesi me shkrim deklarohet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i ofertës nga autori.

(4) Me marrëveshjen e botimit mund të bartet edhe e drejta e botimeve të librave të xhepit, botimit periodik, përkatësisht botimit në vazhdimë, përkthimit dhe ngjashëm.

Përmbajtja e marrëveshjes për botim

Neni 76

(1) Marrëveshja për botim, krahas elementeve të përgjithshme për përmbajtjen e marrëveshjes së autorit të përcaktuara me nenin 65 të këtij ligji e përmban edhe afatin për dorëzimin e dorëshkrimit për botim, numrin e botimeve të posaçme dhe numrin e ekzemplarëve (tirazhin) të secilit botim të posaçëm.

(2) Kompensimi në marrëveshjen e botimit mund të përcaktohet në shumë paushalle apo në përqindje nga çmimi i shitjes me pakicë të ekzemplarit të botimit. Në rast kur kompensimi është i kontraktuar në përqindje nga çmimi i shitjes me pakicë të ekzemplarëve të shitur të veprës, botuesi është i detyruar që t'i mundësojë autorit inspektim në dokumentacionin për ekzemplarët e shitur.

Supozimi i ekskluzivitetit

Neni 77

Për kohëzgjatjen e marrëveshjes së botimit, konsiderohet se autori botuesit në mënyrë ekskluzive ia ka bartur të drejtën e botimit të veprës në gjuhën e njëjtë, përveç artikujve gazetareske, nëse me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe.

Përmirësimi i veprës

Neni 78

Botuesi është i detyruar, që gjatë botimeve të ardhshme t'ia mundësojë autorit përmirësimin apo ndryshimin e veprës, me kusht që kjo të mos shkaktojë shpenzim të konsiderueshëm për botuesin dhe në mënyrë thelbësore të mos e ndryshojë veprën, nëse me marrëveshjen e botimit nuk është përcaktuar ndryshe.

Zhdukja e veprës me fuqi madhore

Neni 79

(1) Në rast kur dorëshkrimi i veprës pas dorëzimit të botuesi, është zhdukur për shkak të fuqisë madhore, autori ka të drejtë në kompensimin që do t'i takonte, nëse vepra ka qenë e botuar.

(2) Në rast kur për shkak të fuqisë madhore, para se të lëshohet në qarkullim është zhdukur botimi i plotë i përgatitur, botuesi ka të drejtë të përgatitë botim të ri, kurse autori ka të drejtë në kompensim si për një botim.

(3) Në rast kur për shkak të fuqisë madhore para se të lëshohet në qarkullim është zhdukur një pjesë e botimit të përgatitur, botuesi ka të drejtë që të botojë vetëm aq ekzemplarë sa janë zhdukur, pa i paguar për këtë kompensim shtesë autorit.

Ndërprerja dhe prishja e marrëveshjes

Neni 80

(1) Marrëveshja e botimit ndërpritet në rast të:

- 1) vdekjes së autorit para përfundimit të veprës autoriale;
- 2) harxhimit të tirazhit të të gjitha botimeve të kontraktuara;
- 3) skadimit të afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes dhe
- 4) rasteve tjera të përcaktuara me ligj apo marrëveshje.

(2) Autori mund ta prishë marrëveshjen e botimit, nëse botuesi pasi është harxhuar tirazhi nga botimi paraprak nuk boton botime të reja të kontraktuara në afatin e përcaktuar me marrëveshjen e botimit. Në rast të prishjes, autori ka të drejtë që ta mbajë kompensimin e fituar, përkatësisht të kërkojë pagesë të kompensimit të kontraktuar, si dhe të drejtë që të kërkojë kompensim të dëmit.

(3) Konsiderohet se tirazhi është i harxhuar sipas këtij ligji, nëse numri i ekzemplarëve të pashitur është më i vogël se 5% nga të gjitha botimet e kontraktuara dhe të realizuara, e në çdo rast nëse është më i vogël se 100 ekzemplarë.

Zhdukja e ekzemplarëve

Neni 81

Në rast kur botuesi dëshiron t'i zhdukë ekzemplarët e veprës të mbetura në tepricë, është i detyruar që së pari t'ia ofrojë autorit.

Nënndarja 2. Marrëveshja për realizim publik

Marrëveshja për realizim publik

Neni 82

Me marrëveshje për realizim publik autori ia transmeton shfrytëzuesit të drejtën për realizim publik të veprës së vet.

Përmbajtja e marrëveshjes për realizim publik

Neni 83

Marrëveshja për realizim publik, krahas elementeve të përgjithshme për përmbajtjen e marrëveshjes së autorit të përcaktuara me nenin 65 paragrafin (3) të këtij ligji, mund ta përmbajë edhe të drejtën e autorit në inspektim në realizimin publik të veprës dhe obligimin e shfrytëzuesit që këtë t'ia mundësojë, si dhe të sigurojë kushte përkatëse teknike për realizimin.

Prishja e marrëveshjes

Neni 84

Në rast kur vepra nuk realizohet në afatin e kontraktuar apo në kushtet e kontraktuara, autori ka të drejtë që ta prishë marrëveshjen, ta mbajë kompensimin tanimë të marrë, të kërkojë pagesë të kompensimit të kontraktuar dhe të kërkojë kompensim të dëmit.

Nënndarja 3. Marrëveshja për porosinë e veprës autoriale

Marrëveshja për porosi

Neni 85

(1) Me marrëveshjen për porosi të veprës autoriale, autori e krijon veprën e porositur autoriale dhe ia dorëzon porositësit.

(2) Porositësi ka të drejtë që ta mbikëqyrë punën dhe të japë udhëzime, nëse me këtë nuk ndërhyr në të drejtën e autorit për krijimtari të lirë.

(3) Autori e mban të drejtën e autorit mbi veprën e porositur, nëse me ligj apo marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe.

Nënndarja 4. Vepra autoriale e krijuar nga marrëdhënia e punës

Vepra autoriale nga marrëdhënia e punës

Neni 86

(1) Në rast kur vepra autoriale është e krijuar nga punëtori gjatë plotësimit të obligimeve të tij punuese, apo sipas udhëzimit të punëdhënësit (në tekstin e mëtejshëm: vepër autoriale nga marrëdhënia e punës), konsiderohet se të drejtat materiale të autorit të asaj vepre, ekskluzivisht i janë bartur punëdhënësit për kohë prej pesë vitesh pas përfundimit të veprës, nëse me marrëveshjen kolektive, përkatësisht me marrëveshjen për punë nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Pas skadimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, të drejtat materiale i takojnë punëtorit, me atë që punëdhënësi mund të kërkojë bartje të sërishme të tyre ekskluzive, nëse i paguan punëtorit kompensim për çdo lloj të veçantë të së drejtës materiale.

(3) Pavarësisht nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, autori ka të drejtë kompensimi për çdo huazim.

(4) Autori nuk mund të heq dorë nga e drejta nga paragrafi (3) i këtij neni.

Përjashtime të bartja në marrëdhënien e punës

Neni 87

Me përjashtim nga neni 86 i këtij ligji:

1) punëtori e mban të drejtën ekskluzive që ta shfrytëzojë veprën autoriale të krijuar nga marrëdhënia e punës, në kuadër të veprave të veta të mbledhura dhe

2) konsiderohet se të drejtat materiale të programit kompjuterik dhe të bazave të të dhënave në mënyrë të pakufizuar i janë bartur punëdhënësit, nëse me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe.

NDARJA 2. Dispozita të veçanta për të drejtat e autorit

Nënndarja 1. Vepra audiovizuele

Vepra audiovizuele

Neni 88

Vepra audiovizuele, sipas këtij ligji, është vepër kinematografike apo vepër tjetër e shprehur në formë të fotografive të lidhura që lëvizin, me apo pa zë, pa marrë parasysh llojin e bartësit që e përmban.

Autorët e veprave audiovizuele

Neni 89

Autorët e veprës audiovizuele, sipas këtij ligji, janë: shkrimtari i skenarit, regjisori kryesor dhe incizuesi kryesor. Në rast kur animacioni nga cilido lloj qoftë është element thelbësor i veprës, për autor konsiderohet edhe vizatuesi kryesor. Në rast kur muzika është elementi thelbësor i veprës, për autor konsiderohet edhe autori i muzikës posaçërisht të krijuar për shfrytëzim në veprën audiovizuele.

Autorët e kontributeve ndaj veprës audiovizuele

Neni 90

Vizatuesi, përkatësisht autori i muzikës, kur nuk konsiderohet për autor të veprës audiovizuele sipas neni 89 të këtij ligji, si edhe skenografi, kostumografi, montazhisti dhe autori i maskave, kanë të drejtë autoriale vetëm mbi kontributet e veta ndaj veprës audiovizuele (në tekstin e mëtejshëm: autorë të kontributeve).

Marrëveshja për produksionin filmik

Neni 91

(1) Me marrëveshje për produksionin filmik rregullohet marrëdhënia e producentit filmik me autorët e veprës audiovizuele dhe autorët e kontributeve, si dhe marrëdhënia ndërmjet vetë autorëve, në pajtim me këtë ligj.

(2) Me lidhjen e marrëveshjes për produksion filmik, konsiderohet se autorët dhe autorët e kontributeve, në mënyrë ekskluzive dhe të pakufizuar ia kanë bartur producentit filmik të gjitha të drejtat e veta materiale të veprës audiovizuele, duke e përfshirë edhe të drejtën e përthimit me titllim apo mbisinkronizim, nëse me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Me lidhjen e marrëveshjes për produksion filmik, autorët e mbajnë të drejtën e kompensimit të drejtë nga producenti filmik, për çdo shfrytëzim nga paragrafi (2) i këtij neni, ndërsa autorët e kontributeve e mbajnë të drejtën që posaçërisht t'i shfrytëzojnë kontributet e veta ndaj veprës audiovizuele, nëse me këtë nuk cenohen të drejtat e producentit filmik.

(4) Autorët dhe autorët e kontributeve nuk mund të heqin dorë nga të drejtat e shënuara në paragrafin (3) të këtij neni.

(5) Producenti filmik është i detyruar që së paku një herë në vit t'u dorëzojë autorëve të veprës audiovizuele raport për të hyrat e realizuara, veç veç për çdo lloj të shfrytëzimit të veprës.

Përfundimi i veprës audiovizuele

Neni 92

(1) Vepra audiovizuele konsiderohet e përfunduar (e krijuar) kur regjisori kryesor do të përcaktojë se është përfunduar ekzemplari i parë standard i veprës që është lëndë e marrëveshjes.

(2) Ndryshimet e ekzemplarit të veprës audiovizuele nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të mundshme vetëm pas pajtimit paraprak të regjisorit kryesor dhe producentit filmik.

(3) Në rast kur ndonjë nga autorët apo autorët e kontributeve nuk do ta kryejë pjesën e vet ndaj veprës audiovizuele apo për shkak të fuqisë madhore këtë nuk mund ta bëjë, nuk ka të drejtë të kundërshtojë që pjesa e krijuar të shfrytëzohet për përfundimin e saj. Për këtë pjesë autori e gëzon të drejtën autoriale përkatëse.

Prishja e marrëveshjes

Neni 93

(1) Në rast kur producenti filmik nuk do ta përfundojë veprën audiovizuele në afat prej pesë vitesh nga lidhja e marrëveshjes për produksion filmik, apo nëse nuk e lëshon në qarkullim veprën e përfunduar audiovizuele në afat prej një viti pas përfundimit të tij, autorët mund ta prishin marrëveshjen nëse nuk është kontraktuar afat tjetër.

(2) Në rastin e prishjes nga paragrafi (1) i këtij neni, autorët dhe autorët e kontributeve e mbajnë të drejtën e pagesës së kompensimit.

Zbatimi i dispozitave tjera ligjore

Neni 94

Me marrëveshjen për produksion filmik, nuk kanë të bëjnë dispozitat e këtij ligji për të drejtën e dorëheqjes nga nenet 21 paragrafi (1) pika 4 dhe 25 dhe për bartjen e të drejtës nga nenet 71 dhe 73 të këtij ligji.

Nëndarja 2. Programi kompjuterik

Programi kompjuterik

Neni 95

Programi kompjuterik sipas këtij ligji, është program në cilëndo qoftë formë të shprehur elektronike, duke e përfshirë edhe materialin përgatitor për përpunim të tij, nëse është krijim individual dhe intelektual.

Të drejtat e autorit

Neni 96

Autori i programit kompjuterik, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ka të drejtë materiale ekskluzive që ta shfrytëzojë programin dhe ta lejojë apo ndalojë shfrytëzimin e programit për:

1) shumëzim, si dhe futje, paraqitje, shfrytëzim, bartje apo ruajtje të programit kompjuterik, nëse këto veprime imponojnë shumëzim të atillë;

2) përkthim, adaptim apo çfarëdo qoftë përpunimi tjetër, si dhe shumëzim i rezultateve nga ai përpunim, pa u cenuar të drejtat e personit që e ka kryer përpunimin e atillë dhe

3) lëshim në qarkullim, si dhe për shërbim të origjinalit nga programi kompjuterik apo ekzemplarët e tij në çfarëdo forme qofshin.

Dispozita të veçanta për kufizim të të drejtave

Neni 97

(1) Nëse me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe, shfrytëzuesi ligjor i programit kompjuterik mundet pa leje të bartësit të së drejtës t'i kryejë veprimet e theksuara në nenin 96 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, në pajtim me dedikimin e tij, duke e përfshirë edhe përmirësimin e gabimeve për shfrytëzimin e programit.

(2) Shfrytëzuesi ligjor i programit kompjuterik mundet që pa leje të bartësit të së drejtës të bëjë ekzemplar rezerv, nëse është kjo e domosdoshme për shfrytëzimin e tij.

(3) Shfrytëzuesi ligjor i programit kompjuterik ka të drejtë që pa leje të autorit ta ndjekë, studiojë apo testojë punën e programit, me qëllim që t'i përcaktojë idetë dhe parimet që janë karakteristikë themelore e elementeve të programit, nëse ka nevojë për këtë gjatë futjes, paraqitjes, shfrytëzimit, transmetimit apo ruajtjes.

(4) Dispozitat nga marrëveshja që janë në kundërshtim me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, janë të pavlefshme.

Dekompilimi

Neni 98

(1) Për shumëzim të kodit dhe për ndryshim të formës së tij, sipas nenit 96 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, nuk nevojitet leja e bartësit të së drejtës, nëse kjo është e nevojshme për marrjen e informatave të nevojshme për arritjen e funksionalitetit (interoperabilitetit) të përbashkët të programit të pavarur të krijuar kompjuterik me programe të tjera, me kusht që të plotësohen kushtet si vijojnë:

1) veprimet e atilla t'i kryejë bartësi i lejes, shfrytëzuesi tjetër ligjor apo personi që është i autorizuar prej tyre dhe punon në emër të tyre dhe për qëllimin e njëjtë;

2) informatat e nevojshme për arritjen e interoperabilitetit të mos jenë paraprakisht të arritshme për personat nga paragrafi 1, pika 1 e këtij neni dhe

3) veprimet e atilla të jenë të kufizuara vetëm në këto pjesë nga programi burimor që janë të nevojshme për arritjen e funksionalitetit (interoperabilitetit) të përbashkët.

(2) Nuk lejohet që informatat e marra nëpërmjet zbatimit të paragrafit (1) të këtij neni të:

1) shfrytëzohen për dedikime tjera, përveç për arritjen e funksionalitetit (interoperabilitetit) të përbashkët të programit kompjuterik të pavarur të krijuar;

2) lëshohen personave tjerë, përveç kur kjo është e nevojshme për arritjen e funksionalitetit (interoperabilitetit) të përbashkët të programit kompjuterik të pavarur të krijuar dhe

3) shfrytëzohen për zhvillimin, prodhimin apo tregtinë me program tjetër kompjuterik, që në shprehjen e vet është e ngjashme në thelb apo të shfrytëzohen për çfarëdo veprimi tjetër me të cilën cenohet e drejta e autorit.

(3) Dispozitat e këtij neni nuk mund të zbatohen në mënyrë që në masë të paarsyeshme do ta cenonte të drejtën e autorit apo do të jetë në kundërshtim me shfrytëzimin e zakonshëm të programit kompjuterik.

KAPITULLI I TRETË TË DREJTA TË PËRAFËRTA

PJESA 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lëndët e të drejtave të përafërta

Neni 99

Lëndët e të drejtave të përafërta janë realizimet e artistëve - realizues; fonogramet e prodhuesve të fonogrameve; videogramet e producentëve filmik; programet e organizatave radiotelevizive; botimet e botuesve dhe bazat e të dhënave të përpiluesve të tyre.

Zbatimi i dispozitave për të drejtën e autorit

Neni 100

Dispozitat e këtij ligji për të drejtën e autorit që kanë të bëjnë me: marrëdhënien ndërmjet të drejtës së autorit dhe të drejtës pronësore (nenet prej 6 deri 9 dhe 11), pjesët përbërëse dhe titujt e veprës (neni 13), prezumpcionin e autorësisë dhe bashkautorësisë (nenet 18 dhe 19), definicionet e të drejtave materiale (nenet prej 28 deri 38), të drejtën e harxhimit gjatë shitjes së parë (neni 29 paragrafi (5)), kufizimin e të drejtave materiale (nenet prej 51 deri 54), mënyrën e llogaritjes së afateve për kohëzgjatjen dhe pasojat nga skadimi i tyre (nenet 60 dhe 62); bartjen (nenet prej 63 deri 71, 73 dhe 74) në mënyrë përkatëse zbatohen edhe për të drejtat e përafërta.

PJESA 2 PËRMBAJTJA E TË DREJTAVE TË PËRAFËRTA

NDARJA 1. Të drejtat e artistëve - realizuesve

Nocioni i artistëve - realizuesve

Neni 101

(1) Artistë - realizues sipas këtij ligji, janë: artistët, këngëtarët, muzikantët, artistët e baletit dhe personat tjerë të cilët me lojë, këngë, valle, fjalim, recitim apo në mënyrë tjetër, realizojnë vepra letrare apo artistike apo vepra nga krijimtaria popullore (në tekstin e mëtejshëm: realizues).

(2) Si realizues, sipas këtij ligji, konsiderohen edhe regjisorët e veprave skenike, dirigjentët e orkestrave dhe koreve, formësuesit (mjeshtërit) e tonit apo të incizimit tonik.

Përfaqësues të përbërjeve të realizuesve

Neni 102

(1) Realizuesit të cilët marrin pjesë në mënyrë kolektive në realizimin e njëjtë, si për shembull: orkestri, kori, ansambli i valleve apo dramatik, grupi apo lloji tjetër i përbërjes, janë të detyruar që ta autorizojnë njërin nga anëtarët-realizuesit e përbërjes për çdo përfaqësues për bartjen e së drejtës për shfrytëzim të realizimit nga neni 106 paragrafi (1) i këtij ligji, përveç nëse me ligj apo rregullat e përbërjes nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Autorizimi nga paragrafi (1) i këtij neni, jepet me shkrim dhe vlen, nëse është dhënë nga shumica e realizuesve në përbërjen nga paragrafi (1) i këtij neni. Autorizimi i përmban: të drejtat për të cilat jepet autorizimi, numrin e përgjithshëm të realizuesve, emrat e tyre, nënshkrimet e anëtarëve që e japin autorizimin, dhe afatin e vlefshmërisë së tij.

(3) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nuk kanë të bëjnë me regjisorët e veprave skenike, dirigjentët dhe solistët.

Të drejtat morale

Neni 103

Realizuesi i ka të drejtat morale ekskluzive si vijojnë:

- 1) të pranohet si realizues i shfaqjes;
- 2) të shënohet emri i tij, pseudonimi apo shenja tjetër, përkatësisht, emri i përbërjes, udhëheqësit artistik të përbërjes dhe solistit, gjatë çdo shfrytëzimi të shfaqjes, përveç nëse kjo është teknikisht e pamundur dhe
- 3) ta kundërshtojë çdo ndryshim, deformim, gjymtim apo zhdukje të realizimit të tij, përkatësisht ta kundërshtojë çdo shfrytëzim të realizimit që mund ta dëmtojë personalitetin e tij, nderin dhe autoritetin.

Të drejtat materiale

Neni 104

(1) Realizuesi ka të drejta materiale ekskluzive që ta lejojë apo ndalojë shfrytëzimin e realizimit të vet për:

- 1) incizim të realizimit të vet të paicizuar;
- 2) kumtim publik të realizimit të vet të paicizuar, përveç për emitim radiodifuziv të realizimit të vet e cila vetvetiu është radiodifuzive apo është e bërë nga incizimi;
- 3) shumëzim të incizimit të realizimit;
- 4) lëshim në qarkullim të origjinalit apo ekzemplarit nga incizimi i realizimit dhe
- 5) vënie në disponim për publikun të incizimit të realizimit.

(2) Shumëzimi i incizimit të realizimit nga paragrafi (1) pika 2 e këtij neni, sipas nenit 28 të këtij ligji, paraqet përpunim të ekzemplarëve të incizimit.

Të drejta tjera të realizuesit

Neni 105

(1) Realizuesi ka të drejtë për pjesë nga kompensimi unik për çdo kumtim publik të fonogramit me realizim të tij, të lëshuar për qëllim komercial, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Realizuesi i cili të drejtën e vet të shumëzimit të incizimit me realizim të vet ia ka bartur prodhuesit të fonogrameve apo producentit filmik në pajtim me këtë ligj, e mban të drejtën e kompensimit për çdo huazim.

(3) Realizuesi ka të drejtë për pjesë nga kompensimi unik për shumëzim për shfrytëzim privat, në pajtim me nenin 46 të këtij ligji.

(4) Realizuesi nuk mund të heq dorë nga e drejta e përcaktuar në paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni.

(5) Botimi për qëllim komercial sipas paragrafit (1) të këtij neni, paraqet shumëzim të fonogramit në numër të mjaftueshëm të ekzemplarëve, të dedikuara për publikun.

Bartja e të drejtës realizuese

Neni 106

(1) Realizuesi mundet me marrëveshje realizuese t'ia bartë personit tjetër të drejtën e vet materiale të shfrytëzimit të realizimit të vet.

(2) Marrëveshja realizuese lidhet me shkrim edhe krahas elementeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 65 të këtij ligji, i përmban edhe: titullin e veprës që realizohet edhe emrin e autorit të veprës, si dhe numrin dhe periudhën e emitimit radiodifuziv, kur marrëveshja ka të bëjë me emitimin radiodifuziv.

Prezumpcioni i bartjes

Neni 107

Nëse me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe, konsiderohet se me lidhjen e marrëveshjes për prodhim të fonogrameve dhe veprës audiovizuele, realizuesi, prodhuesit të fonogramit, përkatësisht producentit filmik, ia ka bartur të gjitha të drejtat e veta materiale, duke e përfshirë edhe të drejtën e mbisinkronizimit të realizimit të vet.

Realizimi nga marrëdhënia e punës

Neni 108

Dispozitat nga neni 86 i këtij ligji për veprat autoriale të krijuara nga marrëdhënia e punës, në mënyrë përkatëse zbatohen në realizimin nga marrëdhënia e punës.

NDARJA 2. Të drejtat e prodhuesve të fonogrameve

Nocioni i prodhuesve të fonogrameve

Neni 109

(1) Prodhues i fonogramit sipas këtij ligji është personi fizik apo juridik që ndërmerr iniciativë, organizim, financim dhe përgjegjësi për incizim të parë të zërave nga realizimi, të zërave të tjerë apo dukurive të zërit (në tekstin e mëtejshëm: fonogram).

(2) Fonogram sipas këtij ligji është incizimi i zërave nga realizimi apo zëra tjerë apo dukuri të zëshme, përveç incizimit të inkuorporuar në vepër audiovizuele.

(3) Incizim, sipas këtij ligji është mishërimi (regjistrimi i bartësit të tonit) të zërave apo dukurive të zërit prej nga ato mund të pranohen, shumëzohen apo kumtohen me ndihmën e mjeteve teknike.

Përmbajtja e të drejtave të prodhuesit të fonogramit

Neni 110

(1) Prodhuesi i fonogramit ka të drejtë që gjatë çdo shfrytëzimi të fonogramit, në mënyrë përkatëse të shënohet emri ose titulli i tij, përveç nëse kjo është e pamundur.

(2) Prodhuesi i fonogramit ka të drejtë materiale ekskluzive që ta shfrytëzojë, lejojë ose ndalojë shfrytëzimin e fonogramit për:

- 1) shumëzim,
- 2) lëshim në qarkullim dhe
- 3) vënie në disponim për publikun.

Të drejta tjera të prodhuesit të fonogrameve

Neni 111

(1) Prodhuesi i fonogrameve ka të drejtë për pjesë nga kompensimi unik nga kumtimi publik i fonogramit të tij të lëshuar për qëllim komercial.

(2) Si fonogram i lëshuar për qëllim komercial konsiderohet edhe fonogrami i vënë në disponim për publikun.

(3) Prodhuesi i fonogrameve dhe realizuesi i shfaqjes së inkorporuar në fonogram kanë të drejtë në pjesë të barabartë nga kompensimi unik nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe.

(4) Në rast nga paragrafi (1) i këtij neni, shfrytëzuesi është i detyruar për çdo shfrytëzim të paguajë kompensim nga paragrafi (1) i këtij neni për të drejtat e prodhuesit të fonogramit dhe për të drejtat e realizuesit, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(5) Prodhuesi i fonogrameve ka të drejtë në pjesë nga kompensimi unik për shumëzim për shfrytëzim privat, në pajtim me nenin 46 të këtij ligji.

NDARJA 3. Të drejtat e producentit filmik

Nocioni

Neni 112

(1) Producenti filmik sipas këtij ligji është person fizik ose juridik që e merr iniciativën, organizimin, financimin dhe përgjegjësinë për krijimin e incizimit të parë të veprës audovizuele (në tekstin e mëtutjeshëm: videogrami).

(2) Videogrami sipas paragrafit (1) të këtij neni është bartësi i fotografisë me incizimin e fotografive që lëvizin me ose pa tingull shoqërues nga të cilat ato mund të pranohen, shumëzohen ose kumtohen me ndihmën e mjeteve teknike.

Përmbajtja e të drejtave të producentit filmik

Neni 113

(1) Producenti filmik ka të drejtë që gjatë çdo shfrytëzimi të videogramit, në mënyrë përkatëse të shënohet emri ose titulli i tij, përveç nëse kjo është e pamundur.

(2) Producenti filmik ka të drejtë materiale ekskluzive që ta lejojë ose ta ndalojë shfrytëzimin e videogramit të vet për:

- 1) shumëzim;
- 2) lëshim në qarkullim
- 3) paraqitja publike;
- 4) emitim radiodifuziv;
- 5) riemitim dhe
- 6) vënie në disponim për publikun.

Të drejta tjera të producentit filmik

Neni 114

Producenti filmik ka të drejtë për pjesë nga kompensimi unik për shumëzim për shfrytëzim privat, në pajtim me nenin 46 të këtij ligji.

NDARJA 4. Të drejtat e organizatës radiotelevizive

Përmbajtja e të drejtave të organizatës radiotelevizive

Neni 115

Organizata radiotelevizive (në tekstin e mëtutjeshëm : organizata RTV) ka të drejta materiale ekskluzive që ta lejojë ose ta ndalojë shfrytëzimin e programeve të veta për:

- 1) incizim të programeve, të bartësve të fotografive dhe/ose tonit;
- 2) shumëzim dhe lëshim në qarkullim të ekzemplarëve të shumëzuar nga incizimet e programeve;
- 3) riemitim;
- 4) transmetim publik, në vende të arritshme për publikun dhe me arkëtim të biletave dhe
- 5) vënia në disponim për publikun.

NDARJA 5. Të drejtat e botuesve

E drejta e botuesit në kompensim nga shumëzimi për shfrytëzim privat

Neni 116

Personi juridik ose fizik që në pajtim me ligjin do të botojë vepër autoriale në formë të librit (botuesi) ka të drejtë për pjesë nga kompensimi unik për shumëzim për shfrytëzim privat, në pajtim me nenin 46 të këtij ligji.

Të drejta në raste të veçanta të botimit

Neni 117

(1) Personi fizik ose juridik i cili për herë të parë në pajtim me ligjin do të botojë ose në mënyrë tjetër do të publikojë vepër autoriale mbi të cilën kanë skaduar të drejtat materiale ekskluzive të autorit, ka të drejta materiale ekskluzive në përputhje me të drejtat materiale të autorit të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Personi fizik i cili për herë të parë në pajtim me ligjin do të botojë koment ose shqyrtim kritik ose shkencor të veprës autoriale të botuar paraprakisht mbi të cilën kanë skaduar të drejtat materiale të autorit, ka të drejta materiale ekskluzive të autorit në përputhje me të drejtat materiale të autorit, të përcaktuara me këtë ligj.

NDARJA 6. Të drejtat e përpiluesit të bazës së të dhënave

Nocioni i përpiluesit të bazës së të dhënave

Neni 118

Përpiluesi i bazës së të dhënave është person fizik ose juridik i cili ka marrë iniciativë dhe përgjegjësi për investim në krijimin e bazës së të dhënave, nëse prezanton se ka kryer investim esencial kualitativ dhe/ose kuantitativ në mbledhjen, verifikimin ose prezantimin e përmbajtjes së saj.

Përmbajtja e të drejtave të përpiluesve të bazës së të dhënave

Neni 119

(1) Përpiluesi i bazës së të dhënave ka të drejtë ekskluzive që të lejojë ose ndalojë shumëzim (tërheqje) dhe/ose lëshim në qarkullim të ekzemplarëve, vënie në disponim për publikun ose forma tjera të kumtimeve publike në tërësi ose pjesë të rëndësishme të bazës së të dhënave (shfrytëzim i sërishëm).

(2) Me shitjen e parë të ekzemplarit të bazës së të dhënave nga ana e bartësit të së drejtës ose me pajtimin e tij, humbet e drejta e kontrollit të shitjes së mëtejshme të ekzemplarëve.

(3) Të drejtat nga paragrafi (1) i këtij neni, zbatohen pa u cenuar të drejtat ekzistuese të pjesëve të bazës së të dhënave.

Vëllimi i mbrojtjes

Neni 120

(1) Mbrojta e të drejtave të përpiluesit të bazës së të dhënave i përfshin:

- 1) përmbajtjen e plotë të bazës së të dhënave;

2) pjesët esenciale të përmbajtjes së saj, të vlerësuara në mënyrë kualitative dhe/ose kuantitative;

3) pjesët joesenciale të përmbajtjes së saj, kur ato shfrytëzohen sërish dhe në mënyrë sistematike dhe në kundërshtim me shfrytëzimin e rregullt ose në masë të paarsyeshme i cenojnë interesat ligjore të përpiluesit të bazës së të dhënave.

(2) Mbrojta e bazës së të dhënave nuk zbatohet për programin kompjuterik të shfrytëzuar për përpilim ose për punë të bazës së të dhënave të arritshme përmes mjeteve elektronike.

Të drejtat dhe obligimet e shfrytëzuesit ligjor

Neni 121

(1) Përpiluesi i bazës së botuar të të dhënave nuk guxon që ta pengojë shfrytëzuesin ligjor të bazës së të dhënave tërësisht, përkatësisht të një pjese të saj, kur është i autorizuar vetëm për atë pjesë, nga shfrytëzimi i pjesëve joesenciale të përmbajtjes së tij të vlerësuar në mënyrë kualitative dhe/ose kuantitative për çfarëdo qoftë qëllimesh.

(2) Shfrytëzuesi i bazës së botuar të të dhënave nuk guxon që të ndërmarrë çfarëdo qoftë veprimesh në kundërshtim me shfrytëzimin e rregullt dhe/ose veprime që në masë të paarsyeshme i cenojnë interesat e përpiluesit të bazës së të dhënave.

(3) Shfrytëzuesi ligjor i bazës së botuar të të dhënave nuk guxon që t'i shkaktojë dëm bartësit të së drejtës autoriale ose të drejtave të përafërta në lidhje me veprat ose lëndët e të drejtave të përafërta që janë të përmbajtura në bazën e të dhënave.

Kufizimi i të drejtave

Neni 122

Shfrytëzimi i pjesëve esenciale të përmbajtjes së bazës së të dhënave nga ana e shfrytëzuesit ligjor është pa leje nga bartësi i të drejtës dhe pa kompensim, nëse kryhet:

1) shumëzim nga baza joelektronike e të dhënave për qëllime private;

2) shumëzim për ilustrim në procesin mësimor ose për hulumtime shkencore, nëse burimi është shënuar dhe në vëllim të arsyeshëm me qëllim jokomercial dhe

3) lëshimi në qarkullim i ekzemplarëve, vënia në disponim për publikun ose forma tjera të kumtimit publik për qëllime të sigurisë publike, në procedura administrative dhe gjyqësore.

PJESA 3

KOHËZGJATJA E TË DREJTAVE TË PËRAFËRTA

NDARJA 1. Kohëzgjatja e të drejtave të realizuesve

Neni 123

(1) Të drejtat realizuese materiale zgjasin 50 vjet nga dita e realizimit. Nëse në këtë periudhë incizimi nga shfaqja e tij ka qenë për herë të parë e dhënë në pajtim me ligjin ose e kumtuar publikisht në pajtim me ligjin, të drejtat e realizuesit zgjasin 50 vjet, duke llogaritur nga shfaqja e tij e parë në pajtim me ligjin, përkatësisht kumtimin publik në pajtim me ligjin.

(2) Të drejtat morale nga neni 103 i këtij ligji, zgjasin edhe pas skadimit të afateve të kohëzgjatjes së të drejtave të autorit, të përcaktuara me këtë ligj. Dispozita për realizimin e të drejtave morale nga neni 61 i këtij ligji në mënyrë përkatëse zbatohet për të drejtat e realizuesve.

NDARJA 2. Kohëzgjatja e të drejtave të prodhuesit të fonogrameve

Neni 124

Të drejtat e prodhuesit të fonogrameve zgjatin 50 vjet nga dita e realizimit të fonogramit të parë. Nëse në këtë periudhë fonogrami ka qenë për herë të parë i lëshuar në pajtim me ligjin, të drejtat e producentit zgjasin 50 vjet, duke llogaritur nga botimi. Nëse në këtë periudhë fonogrami nuk është botuar në pajtim me ligjin por është kumtuar publikisht në pajtim me ligjin, të drejtat e producentit zgjatin 50 vjet nga dita e kumtimit.

NDARJA 3. Kohëzgjatja e të drejtave të producentit filmik

Neni 125

Të drejtat e producentit filmik zgjatin 50 vjet nga dita e përfundimit të incizimit. Nëse në këtë periudhë incizimi ka qenë për herë të parë i publikuar në pajtim me ligjin ose i kumtuar publikisht në pajtim me ligjin, të drejtat e producentit zgjasin 50 vjet, duke llogaritur nga publikimi i tij i parë në pajtim me ligjin, përkatësisht kumtimi publik në pajtim me ligjin.

NDARJA 4. Kohëzgjatja e të drejtave të organizatës RTV

Neni 126

Të drejtat e organizatës RTV zgjatin 50 vjet nga dita e emitimit të parë radiodifuziv të programit.

NDARJA 5. Kohëzgjatja e të drejtave të botuesit dhe të drejtave të botimit në raste të veçanta

Neni 127

- (1) Të drejtat e botuesit zgjatin 50 vjet nga dita e botimit në pajtim me ligjin.
- (2) Të drejtat nga neni 117 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji zgjatin 25 vjet nga botimi i parë në pajtim me ligjin, përkatësisht publikimi në pajtim me ligjin.

NDARJA 6. Kohëzgjatja e të drejtave të përpiluesit të bazës së të dhënave

Neni 128

(1) Të drejtat e përpiluesve të bazës së të dhënave zgjatin 15 vjet pas kryerjes së përpilimit të bazës së të dhënave. Nëse në këtë periudhë është botuar në pajtim me ligjin, të drejtat do të zgjatin 15 vjet nga ky botim.

(2) Afati për mbrojtje i përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni fillon të rrjedhë përsëri me çdo ndryshim të konsiderueshëm, të vlerësuar në mënyrë kualitative dhe/ose kuantitative në përmbajtjen e bazës së të dhënave duke e përfshirë edhe çdo ndryshim thelbësor që dej nga kumulimi i plotësimeve të njëpasnjëshme, shlyerjeve ose ndryshimeve që e kualifikon bazën e të dhënave si investim të ri thelbësor të vlerësuar në mënyrë kualitative ose kuantitative.

KAPITULLI I KATËRT

MENAXHIMI KOLEKTIV ME TË DREJTËN E AUTORIT DHE ME TË DREJTAT E PËRAFËRTA

PJESA 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Menaxhimi individual dhe kolektiv

Neni 129

(1) Bartësit e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta mund t'i realizojnë të drejtat e përcaktuara me këtë ligj në mënyrë individuale (në veçanti për secilën vepër autoriale, përkatësisht lëndë të së drejtës së përafërt), personalisht, përkatësisht përmes përfaqësuesit ose në mënyrë kolektive, (bashkërisht për më shumë vepra ose lëndë të të drejtave të përafërta dhe për më shumë bartës të të drejtave) përmes organizimit të menaxhimit kolektiv me të drejtat, në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Menaxhimi kolektiv me të drejtat nga paragrafi (1) i këtij neni i përfshin: punët juridike me shfrytëzuesit e të drejtave, grumbullimin e kompensimeve nga shfrytëzuesit, shpërndarjen e tyre dhe mbrojtjen e të drejtave para organeve shtetërore dhe subjekteve tjera.

(3) Në mënyrë kolektive menaxhohen të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta vetëm për veprat e botuara autoriale dhe për lëndët e botuara të të drejtave të përafërta.

(4) Publikimi i incizimeve të shfaqjeve konsiderohet publikim sipas paragrafit (3) të këtij neni.

(5) Në rast të menaxhimit kolektiv, të drejtat barten pa përjashtim.

Realizimi i menaxhimit kolektiv

Neni 130

(1) Menaxhimi kolektiv realizohet për të drejta të përcaktuara me këtë ligj në raste kur nuk është i mundur realizimi individual i të drejtave, për shkak të karakterit të veprave autoriale, përkatësisht të lëndëve të të drejtave të përafërta dhe për shkak të kushteve dhe mënyrës së shfrytëzimit të tyre.

(2) Menaxhimi kolektiv realizohet edhe për të drejta ekskluzive që mund të realizohen edhe individualisht.

Të drejtat që menaxhohen në mënyrë kolektive

Neni 131

Të drejtat që mund të menaxhohen në mënyrë kolektive kryesisht janë:

- 1) kumtimi publik për vepra muzikore joskenike dhe vepra letrare joskenike;
- 2) e drejta e autorit për kompensim nga e drejta e trashëgimisë;
- 3) e drejta e autorit në kompensim nga shërbimi publik;
- 4) e drejta e kompensimit të autorit dhe realizuesit për huazimin e fonogrameve ose videogrameve;
- 5) e drejta e kompensimit të realizuesit për emitim radiodifuziv dhe kumtim tjetër publik të realizimit të vet që vetvetiu është radidifuzive ose është bërë nga incizimi;
- 6) e drejta e kompensimit të realizuesit dhe të prodhuesit të fonogrameve nga kompensimi unik nga njoftimi publik i fonogrameve me realizime të publikuara për qëllim komercial;
- 7) e drejta e kompensimit të autorit dhe të realizuesit nga shumëzimi në letër ose në bartës të ngjashëm të regjistrimit, nëpërmjet fotokopjimit ose cilëndo qoftë teknike të ngjashme me efekte të ngjashme, për shfrytëzim privat;
- 8) e drejta e kompensimit të autorit, realizuesit, prodhuesit të fonogramit nga shumëzimi i fonogramit për shfrytëzim privat;
- 9) e drejta e kompensimit të autorit, realizuesit dhe të prodhuesit të videogramit (producentit filmik) nga shumëzimi i videogramit për shfrytëzim privat dhe
- 10) e drejta e riemitimit kabllovik të veprave autoriale dhe të lëndëve të të drejtave të përafërta, e cila si e drejtë ekskluzive, detyrimisht menaxhohet në mënyrë kolektive, përveç për vepra dhe lëndë të të drejtave të përafërta që i ritransmeton organizata radiotelevizive, pavarësisht nëse bëhet fjalë për të drejtën e saj personale ose të drejtën për ritransmetim dhe është transmetuar nga bartës tjetër i së drejtës.

PJESA 2

ORGANIZATA PËR MENAXHIM KOLEKTIV

Organizata për menaxhim kolektiv

Neni 132

(1) Menaxhim kolektiv me të drejtën e autorit dhe me të drejtat e përafërta mund të kryejë personi juridik i themeluar nga bartës të të drejtave (persona fizikë dhe/ose juridikë) për menaxhim kolektiv me të drejtat, që punon në emrin e vet e në llogari të bartësve të të drejtave dhe në bazë të lejes nga Ministria e Kulturës (në tekstin e mëtutjeshëm: organizata).

(2) Organizata punon me qëllim jofitimprurës, në bazë të parimit të racionalitetit dhe transparencës, dhe me respektimin e rregullave të konkurrencës.

(3) Organizata mund të themelohet për lloje të caktuara të të drejtave ose për të drejta që u takojnë bartësve të veçantë.

(4) Kryerjen e punëve të caktuara administrative, teknike ose ndihmëse, organizata mund t'ia ngarkojë personit tjetër fizik ose juridik me marrëveshje me shkrim.

Obligimet e organizatës

Neni 133

Organizata është e detyruar që:

- 1) t'i mbrojë interesat e bartësve të të drejtave me të cilët menaxhojnë nëpërmjet përcjelljes së shfrytëzimit të tyre në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit;
- 2) t'i kryejë punët juridike dhe marrëdhëniet e bartësve të të drejtave me shfrytëzuesit dhe udhëheq procedura para gjykatave dhe organeve tjera, për shkak të mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta dhe të ngjashme;
- 3) të miratojë dhe botojë akte të përgjithshme për grumbullimin dhe shpërndarjen e kompensimeve nga shfrytëzimi, në pajtim me ligjin;
- 4) të lidhë marrëveshje me organizata përkatëse në vendet e huaja;
- 5) pa përjashtim ta bartë të drejtën për shfrytëzimin e veprave autoriale dhe lëndëve të të drejtave të përafërta me marrëveshje ose në mënyrë tjetër me shkrim;
- 6) t'i grumbullojë kompensimet e përcaktuara nga shfrytëzuesit dhe e kryen shpërndarjen e tyre bartësve të të drejtave në pajtim me ligjin dhe me aktet e përgjithshme;
- 7) të kërkojë nga shfrytëzuesit informata edhe dokumente të nevojshme për përcaktimin e lartësisë së kompensimit për shfrytëzimin e të drejtave;
- 8) të kryejë kontroll të shfrytëzimit të veprave autoriale, përkatësisht të lëndëve të të drejtave të përafërta;
- 9) të sigurojë kontroll të brendshëm, raportim dhe përgjegjësi të organeve dhe personave për punët në kompetencë të tyre në pajtim me ligjin me aktet e përgjithshme;
- 10) të sigurojë dhe mundësojë transparencë në punë (siguron qasje të bartësve të të drejtave në informatat për shfrytëzimin e të drejtave, për mjetet e grumbulluara dhe për shpërndarjen);
- 11) të sigurojë dhe mundësojë inspektim në punën dhe të dhënat nga ana e bartësve të të drejtave, në mënyrë, në vëllim dhe në kushte të përcaktuara me ligj dhe me akte të përgjithshme të organizatës dhe
- 12) të sigurojë dhe mirëmbajë kushte hapësinore, kadrovike dhe të tjera të përcaktuara me këtë ligj për shkak të realizimit me sukses të punës.

Anëtarët e organizatës

Neni 134

(1) Me të drejtat e përcaktuara me këtë ligj në organizatë menaxhojnë dhe vendosin anëtarët e organizatës (bartësit e të drejtave), në pajtim me këtë ose ligj tjetër.

(2) Organizata që kryen menaxhim kolektiv të këtij ligji, i menaxhon të drejtat e të gjithë bartësve të të drejtave, për të cilat ka marrë leje nga Ministria e Kulturës, në pajtim me këtë ligj ose me statutin, përkatësisht me marrëveshjen për themelim.

NDARJA 1. Njoftimi, dorëzimi i të dhënave dhe leja për shfrytëzim

Subjektet e detyruara për dorëzimin e njoftimit, të dhënave dhe kërkesës për leje

Neni 135

(1) Shfrytëzuesi në rastet nga neni 137 pikat 1, 3 dhe 4 të këtij ligji, është i detyruar që më së voni 15 ditë para shfrytëzimit të veprave autoriale dhe të lëndëve të të drejtave të përafërta, ta njoftojë organizatën dhe të kërkojë leje për shfrytëzim, ndërsa në afatin vijues, jo më të gjatë se 15 ditë nga dita e shfrytëzimit, t'i dorëzojë organizatës të dhëna të plota për veprat e shfrytëzuara, përkatësisht lëndët, për vendin dhe kohën e shfrytëzimit dhe të kryejë pagesë të kompensimeve për shfrytëzim.

(2) Shitësi, përkatësisht galeristi, organizatori i shitjes publike, galeria artistike ose ndërmjetësuesi tjetër që kryen shitje të veprave artistike sipas neni 43 paragrafi (3) të këtij ligji dhe origjinalet (dorëshkrimet) e veprave muzikore dhe letrare nga neni 44 të këtij ligji, është i detyruar që t'i dorëzojë në organizatën për menaxhim kolektiv të të dhënave për veprat e tjetërsuara, për pronarin dhe ndërmjetësuesin, për marrëveshjet për shitje dhe për vërtetimet për origjinalitetin e veprave, për çmimin e shitjes në afat prej 30 ditësh pas shitjes së kryer.

(3) Prodhuesit dhe importuesit e aparateve për incizim vizual dhe tonik, të aparateve për fotokopjim, të bartësve të pa incizuar të tonit dhe të tonit dhe fotografisë, si dhe personat që kryejnë shërbime të fotokopjimit janë të detyruar që me kërkesë të organizatës për menaxhim kolektiv t'i dorëzojnë të dhëna për llojin dhe numrin e aparateve të shitura dhe të importuara dhe bartësve të tonit dhe të tonit dhe fotografisë, si dhe të dhëna për fotokopjet e bëra gjatë muajit të caktuar.

(4) Organizatat RTV janë të detyruara që një herë në muaj t'i dorëzojnë organizatës për menaxhim kolektiv pasqyra të veprave autoriale të transmetuara, përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta, në formë dhe përmbajtje të përcaktuara me aktet nga neni 139 të këtij ligji.

(5) Shfrytëzuesi është i detyruar që pa prolongim ta njoftojë organizatën përkatëse për çdo ndryshim të rrethanave për shfrytëzim publik ose për ndalimin e tij, për shkak të ndryshimeve të kushteve të lejes, përkatësisht tërheqjes së lejes.

(6) Në rastet kur sipas paragrafit (1) të këtij neni organizata nuk është e njoftuar, nuk i janë dorëzuar të dhëna të plota ose nuk është marrë leje, me kërkesë të saj, gjykata kompetente përcakton masë të përkohshme-ndalim për shfrytëzim.

(7) Kur kryerja e shërbimeve/veprimtarive të caktuara nga neni 137 të këtij ligji (hotelierike, të vendosjes, transportuese, shitjes-galerike, koncertit, interpretimit, skenës/estradës, radiodifuzive etj) është e lidhur me shfrytëzimin e të drejtës që menaxhohet në mënyrë kolektive, organi kompetent për lëshimin e lejes/aktvendimit për kryerjen e veprimtarisë, të njëjtën do ta lëshojë, nëse kryerësi i veprimtarisë paraprakisht ka lidhur marrëveshje me organizatën kompetente për menaxhim kolektiv.

Kontrolli i shfrytëzimit

Neni 136

(1) Organizata ka të drejtë që ta kontrollojë shfrytëzimin e veprave autoriale dhe lëndëve të të drejtave të përafërta, për menaxhimin kolektiv me të drejtat e të cilave ka leje.

(2) Shfrytëzuesit e veprave autoriale dhe të lëndëve të të drejtave të përafërta janë të detyruar që organizatës t'i japin të dhëna relevante për shfrytëzim, si dhe të mundësojnë inspektim në dokumentacion.

(3) Në kryerjen e kontrollit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, me kërkesë të organizatës për menaxhim kolektiv, organet kompetente të administratës shtetërore janë të detyruara që të japin të dhëna dhe informata me rëndësi për punën e organizatës.

NDARJA 2. Kompensimet për shfrytëzim

Bazat për përcaktimin e kompensimeve

Neni 137

Kompensimet për shfrytëzimin e veprës autoriale, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta përcaktohen sipas bazave si vijon:

1) kur shfrytëzimi i veprës autoriale, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta është e domosdoshme që për kryerjen e veprimtarisë së shfrytëzuesit, përkatësisht varësisht nga shfrytëzimi i tyre (të koncertit, interpretimit, vallëzimit etj), kompensimi për shfrytëzim përcaktohet, sipas rregullës, në përqindje nga të hyrat që shfrytëzuesi i realizon me shfrytëzimin e veprës autoriale dhe/ose lëndës së të drejtës së përafërt;

2) kur shfrytëzimi i veprës autoriale, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta është e domosdoshme që për kryerjen e veprimtarisë së shfrytëzuesit, përkatësisht varësisht nga shfrytëzimi i tyre, ndërsa është e pamundur përcaktim i veçantë i të hyrave të veçanta të realizuara nga shfrytëzimi (transmetimi radiodifuziv), kompensimi për shfrytëzim përcaktohet në përqindje nga të hyrat që i përfshin mjetet e taksës dhe/ose parapagimit radiodifuziv, nga reklamat, nga sponsorimet, nga dotacionet dhe nga të hyrat nga qarkullimi i programeve. Si të hyra nuk konsiderohen mjetet për tatimin mbi vlerën e shtuar, mjetet nga kreditë dhe kamatat e kredive;

3) nëse me shfrytëzimin publik të veprës autoriale, përkatësisht lëndës së të drejtës të përafërt nuk realizohen të hyra (shfaqje, manifestime etj.), kompensimi mund të përcaktohet në përqindje nga shpenzimet e nevojshme për shfrytëzimin e veprës autoriale, përkatësisht lëndës së të drejtës së përafërt, siç janë: kompensimet ose rrogat e autorëve, përkatësisht bartësit e të drejtave të përafërta, shpenzimet për shfrytëzimin e hapësirës gjatë shfrytëzimit të veprës autoriale, përkatësisht lëndës së të drejtës së përafërt dhe shpenzime tjera përkatëse;

4) gjatë përcaktimit të kompensimeve nga pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, përcaktohet edhe shuma më e ulët nominale (absolute) e kompensimit dhe

5) nëse shfrytëzimi i veprës autoriale, përkatësisht lëndës së të drejtës së përafërt nuk është i domosdoshëm për kryerjen e veprimtarisë së shfrytëzuesit, mirëpo kontribuon në rritjen e pëlqimit të shfrytëzuesve të fundit të shërbimeve të tyre (kapacitetet e vendosjes, hotelet, hapësirat e ekspozitave, objektet hotelerike, mjetet transportuese dhe veprimtaritë tjera të ngjashme), kompensimi përcaktohet në shuma paushalle, edhe atë për shfrytëzimet e përhershme dhe të përkohshme të veprës autoriale, përkatësisht të të drejtës së përafërt.

Përcaktimi i lartësisë së kompensimeve

Neni 138

Gjatë përcaktimit të lartësisë së kompensimeve merren parasysh:

- 1) të drejtat, llojet dhe vëllimi i shfrytëzimit të tyre;
- 2) numri i shfrytëzuesve potencialë;
- 3) kategoria dhe madhësia e hapësirës;
- 4) kohëzgjatja dhe numri i shfrytëzimeve;
- 5) dallimi në çmimet në punën e shfrytëzuesit për shkak të shfrytëzimit të veprave, përkatësisht lëndëve të të drejta të përafërta;
- 6) strukturën dhe natyrën e programit (formatin e servisit radiodifuziv), në pajtim me lejen e lëshuar për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive (te transmetimi radiodifuziv);
- 7) interesat religjioze, kulturore, shoqërore dhe sociale të shfrytëzuesve dhe
- 8) interesat e të rinjve dhe personave me nevoja të veçanta.

Aktet për përcaktimin e kompensimeve

Neni 139

(1) Lartësia e kompensimeve për shfrytëzim, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, përcaktohet me:

1) marrëveshje të përgjithshme ndërmjet organizatës dhe shoqatave të shfrytëzuesve të kategorive të veçanta, përkatësisht dhomat e tyre që e përfaqësojnë shumicën e shfrytëzuesve (marrëveshje e përgjithshme);

2) marrëveshje individuale ndërmjet organizatës dhe shfrytëzuesit individual (marrëveshje individuale) dhe

3) akti i përgjithshëm i organizatës për përcaktimin e lartësisë së kompensimit për shfrytëzim (në tekstin e mëtutjeshëm: tarifa).

(2) Për lloj dhe vëllim të njëjtë të shfrytëzimit të veprave autoriale dhe lëndëve të drejta të përafërta nga ana e subjekteve me veprimtari të njëjtë ose të ngjashme, në marrëveshjen e përgjithshme, nuk mund të përcaktohen shuma më të larta të kompensimeve për shfrytëzim nga

ato që janë të përcaktuara në Tarifë, ndërsa me marrëveshjen individuale, nuk mund të përcaktohen shuma më të larta të kompensimeve për shfrytëzim nga ato që janë të përcaktuara në marrëveshjen e përgjithshme, përkatësisht në Tarifë.

(3) Asnjëra nga palët kontraktuese nga paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk guxon që të refuzojë negociatave për marrëveshje të përgjithshme dhe marrëveshje individuale. Refuzimi i negociatave nga organizata, si dhe zvarritja e paarsyeshme e negociatave me shfrytëzuesin ose me shoqatat përkatëse të shfrytëzuesve, përkatësisht me dhomat e tyre, paraqesin baza për heqjen e lejes për menaxhim kolektiv.

(4) Nëse shfrytëzuesi dhe organizata nuk lidhin marrëveshje individuale për kushtet dhe lartësinë e kompensimit, shfrytëzuesi është i detyruar që të paguajë kompensim sipas marrëveshjes së përgjithshme, përkatësisht Tarifës.

Procedura për miratimin e tarifës

Neni 140

(1) Organizata është e detyruar që para miratimit të tarifës nga neni 139 paragrafi (1) pika 3 të këtij ligji të kërkojë mendim nga shfrytëzuesit, nga shoqatat përkatëse të shfrytëzuesve, përkatësisht nga dhomat e tyre.

(2) Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës nuk dorëzojnë mendime të veta me shkrim, do të konsiderohet se pajtohen me propozim-tarifën.

(3) Nëse organizata nuk i pranon në tërësi ose pjesërisht propozimet nga mendimet e subjekteve nga paragrafi (1) i këtij neni, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtave, ajo është e detyruar që të kërkojë mendim nga Komisioni për Ndërmjetësim në të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e përafërta të këtij ligj (në tekstin e mëtutjeshëm Komisioni për Ndërmjetësim) në lidhje me lëndën e mospajtimit. Komisioni do të japë mendim në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës. Mendimi përmban vlerësim për atë nëse propozim-tarifa e shoqatës i përfshin të drejtat për të cilat kjo shoqatë ka leje, si dhe atë nëse kompensimet në tarifë janë të përcaktuara në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Nëse Komisioni nuk jep mendim në afatin e caktuar, konsiderohet se pajtohet me propozim-tarifën.

(4) Tarifa, pas miratimit të saj nga organi kompetent i organizatës, botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nëndarja 1. Komisioni për Ndërmjetësim

Kompetencat

Neni 141

(1) Komisioni për Ndërmjetësim, krahas ndërmjetësimit nga neni 140 i këtij ligji, ndërmjetëson edhe gjatë lidhjes së marrëveshjeve për ritransmetim kabllor me kërkesë të cilësdo palë kontraktuese, ndërsa mund të ndërmjetësojë edhe gjatë lidhjes së marrëveshjeve për llojet tjera të shfrytëzimit të veprave autoriale, nëse të dy palët e kërkojnë këtë.

(2) Komisioni për Ndërmjetësim në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, u ndihmon palëve kontraktuese për lidhjen e marrëveshjes dhe mund të parashtojë propozime te palët.

(3) Propozimet nga paragrafi (2) i këtij neni, konsiderohen të pranuar, nëse asnjëra prej palëve kontraktuese nuk shpreh kundërshtim për propozimet në afat prej tre muajsh nga pranimi i propozimeve.

(4) Propozimet dhe njoftimi për kundërshtim nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni dorëzohen me shkrim, me postë rekomanduese.

Përbërja dhe emërimi

Neni 142

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit të Kulturës, e emëron Komisionin për Ndërmjetësim.

(2) Komisionin për Ndërmjetësim e përbëjnë kryetari dhe katër anëtarë me mandat prej katër vitesh.

(3) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për Ndërmjetësim emërohen nga radhët e ekspertëve të shquar të pavarur dhe të paanshëm nga sfera e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, të cilët më punën e tyre dhe me njohuritë e zbatimit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta mund të kontribuojnë në realizimin e qëllimeve për të cilat formohet.

(4) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për Ndërmjetësim, para emërimit, japin deklaratë me shkrim se nuk ekziston konflikt interesash në lidhje me punën e Komisionit.

Puna

Neni 143

(1) Komisioni për Ndërmjetësim punon në mbledhje dhe vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm.

(2) Komisioni për Ndërmjetësim miraton rregullore të punës.

(3) Komisioni për ndërmjetësim mund të ftojë në mbledhje që të jenë të pranishëm nga një përfaqësues i autorizuar nga palët kontraktuese dhe persona tjerë profesionalë nga sfera përkatëse. Përfaqësuesit e palëve kontraktuese dhe ekspertët e ftuar në mënyrë të barabartë marrin pjesë në punën e Komisionit, pa të drejtë vote.

(4) Punët administrative dhe teknike të Komisionit për Ndërmjetësim i kryen Ministria e Kulturës.

NDARJA 4. Shpërndarja e kompensimeve

Akti i përgjithshëm për shpërndarje

Neni 144

(1) Organizata miraton akt të përgjithshëm për shpërndarjen e kompensimeve në pajtim me ligjin dhe statutin, përkatësisht me marrëveshjen për themelim.

(2) Shpërndarja e kompensimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhet në pajtim me evidencat dhe të dhënat për shfrytëzimin e veprave, përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta, ndërsa në mënyrë kur është e pamundur ose shkakton shpenzime të paarsyeshme sipas parimit të drejtësisë.

(3) Për mbulimin e shpenzimeve të përgjithshme për punën e organizatës mund të shfrytëzohen mjete nga kompensimet e grumbulluara në shumën e përcaktuar në statut, përkatësisht në marrëveshjen për themelim në shumë deri në 20%, ndërsa në rast të menaxhimit kolektiv me kompensimin unik të përcaktuar me këtë ligj, jo më shumë se 30%.

(4) Llogaritë individuale dhe pagesat e kompensimeve kryhen së paku një herë në vit.

(5) Akti i përgjithshëm për shpërndarje, pas miratimit të tij nga organi kompetent i organizatës, shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Rastet e veçanta për shpërndarjen e kompensimit

Neni 145

Shpërndarja e ndërsjellë e kompensimeve unike të përcaktuara me nenet 46, 105, 111, 114 dhe 116 të këtij ligji, kryhet në përpjesëtimin si vijon:

1) nga kompensimet e grumbulluara për shumëzim për shfrytëzim privat të fonogrameve, përkatësisht videogrameve në pajtim me këtë ligj, autorët marrin 40%, realizuesit 30%, ndërsa prodhuesit e fonogrameve, përkatësisht videogrameve (producentët filmikë) 30%;

2) kompensimet e grumbulluara për shumëzim për shfrytëzim privat në letër ose bartës të ngjashëm në pajtim me këtë ligj, shpërndahen ndërmjet autorëve dhe realizuesve në përpjesëtim prej nga 50% dhe

3) kompensimi i grumbulluar nga kumtimi publik i fonogramit të lëshuar për qëllim komercial, duke e përfshirë edhe transmetimin radiodifuziv në pajtim me këtë ligj, shpërndahet ndërmjet realizuesve dhe prodhuesve të fonogrameve në përpjesëtim prej nga 50%.

PJESA 3

PROCEDURA PËR LËSHIMIN E LEJES PËR MENAXHIM KOLEKTIV

Kërkesa për lëshimin e lejes

Neni 146

- (1) Leja për menaxhim kolektiv lëshohet me kërkesë të organizatës.
- (2) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, organizata i parashton aktvendimin për regjistrim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, statutin përkatësisht marrëveshjen për themelim dhe dokumentacionin tjetër të përcaktuar me këtë ligj.
- (3) Dispozita nga paragrafi (2) i këtij neni zbatohet në mënyrë përkatëse edhe për organizatën nga neni 149 paragrafi (3) i këtij ligji.

Përmbajtja e statutit, përkatësisht marrëveshjes për themelimin e organizatës

Neni 147

Statuti, përkatësisht marrëveshja për themelim, krahas elementeve të përcaktuara me ligj tjetër, duhet të përmbajë edhe dispozita për realizimin e obligimeve të organizatës të përcaktuara me këtë ligj, e veçanërisht:

- 1) llojet dhe vëllimin e të drejtave që realizohen;
- 2) organet e organizatës, kompetencën e tyre, raportimin, përgjegjësinë, mënyrën e punës, zgjedhjen dhe shkarkimin;
- 3) kushtet dhe mënyrën e marrjes së statusit të anëtarit të organizatës;
- 4) mënyrën dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të organizatës në organet e organizatës dhe të drejtat e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë;
- 5) procedurën për përjashtim (ndalim) nga e drejta e menaxhimit kolektiv nga ana e bartësit të së drejtës, përveç në rast kur bartësi i të drejtës nuk mund të heq dorë nga kjo e drejtë, në pajtim me këtë ligj;
- 6) procedurën për mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve;
- 7) procedurën për miratimin e akteve të përgjithshme;
- 8) mënyrën e grumbullimit të kompensimeve dhe parimet për shpërndarjen e tyre;
- 9) përcaktimin e procedurës dhe parimet për lidhjen e marrëveshjes me organizata përkatëse të huaja dhe mënyra e sigurimit të shkëmbimit të informatave për menaxhimin kolektiv;
- 10) mënyrën dhe kushtet për sigurimin e kontrollit të bredshmëm dhe mbikëqyrjen e punës;
- 11) mënyrën dhe kushtet e sigurimit të transparencës në punë ndaj anëtarëve, ndaj shfrytëzuesve dhe ndaj publikut më të gjerë dhe
- 12) kushtet për shuarjen e organizatës dhe shpërndarjen e pronës.

Përmbajtja e dokumentacionit tjetër

Neni 148

Dokumentacioni tjetër duhet të përmbajë:

- 1) numrin e pritur dhe të sigurt të bartësve të të drejtave dhe vëllimin e të drejtave të cilat organizata për menaxhim kolektiv do t'i realizojë, përkatësisht numrin e atyre bartësve të cilët i janë bashkëngjitur organizatës dhe vëllimin e të drejtave të tyre.
- 2) vlerësimin e arsyeshmërisë ekonomike për menaxhim kolektiv efikas dhe ekonomik me të drejta të caktuara dhe
- 3) dëshminë se organizata i përmbush kushtet e caktuara kadrovike, hapësinore dhe të tjera (hapësirë afariste përkatëse, pajisje për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave për menaxhim kolektiv dhe aftësim profesional të kuadrove për menaxhim kolektiv nga së paku një jurist të diplomuar dhe ekonomist të diplomuar - për udhëheqjen e kontabilitetit, nëpërmjet shërbimit të vet profesional ose me ngarkimin e punëve personit të tretë).

Veprimi për kërkesën

Neni 149

(1) Ministria e Kulturës, në afat prej 60 ditësh nga pranimi i kërkesës, miraton aktvendim për dhënie e lejes ose për refuzimin e kërkesës. Kundër aktvendimit mund të ngritet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(2) Për menaxhim kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta nga ky ligj, për lloj të njëjtë të të drejtave përkatësisht shfrytëzim të të drejtave, sipas rregullës i lëshohet leje njëjës organizatë.

(3) Në rast të kompensimit unik të përcaktuar në nenet 46, 105, 111, 114 dhe 116 të këtij ligji, leja i lëshohet organizatës së autorizuar nga organizatat përkatëse përkatësisht të themeluar nga bartësit përkatës të të drejtave, ndërmjet organizatave përkatësisht bartësve të të drejtave kryhet shpërndarja e kompensimit unik.

(4) Nëse për të drejtat e njëjta janë parashtruar një ose më shumë kërkesa, Ministria e Kulturës do t'i lëshojë leje asaj organizate që në mënyrë të bazuar do të vlerësojë se sipas dokumentacionit të dorëzuar më me sukses do ta realizojë menaxhimin kolektiv në aspekt të plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe në aspekt të vëllimit të të drejtave dhe numrit të bartësve.

Fillimi i punës

Neni 150

(1) Aktvendimi për dhënie e lejes nga neni 149 të këtij ligji botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe hyn në fuqi me ditën e botimit.

(2) Aktet e përgjithshme (Tarifa dhe akti për shpërndarjen e kompensimeve) organizata i miraton dhe i publikon në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktvendimit për dhënie e lejes, në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Organizata fillon punën më së voni 30 ditë nga publikimi i akteve nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Mosmiratimi i akteve në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, është bazë për heqjen e lejes për menaxhim kolektiv.

Bazat për refuzimin e kërkesës

Neni 151

Ministria e Kulturës miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës, nëse:

- 1) nuk është dorëzuar dokumentacioni i tërësishëm i përcaktuar me këtë ligj;
- 2) statuti, përkatësisht marrëveshja për themelim nuk është në pajtim me këtë ligj dhe
- 3) vlerëson se organizata sipas dokumentacionit të dorëzuar nuk i plotëson kushtet për kryerje me sukses të menaxhimit kolektiv.

Zbatimi i rregullave tjera

Neni 152

Procedura për lëshimin e lejes zbatohet në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

PJESA 4

KONTROLI DHE MBIKËQYRJA MBI PUNËN E ORGANIZATËS

Subjektet që e realizojnë kontrollin dhe mbikëqyrjen

Neni 153

(1) Kontrolli i punës së organizatës realizohet nga ana e organeve kompetente të organizatës dhe nga bartësit e të drejtave që i menaxhon organizata.

(2) Organ shtetëror kompetent për mbikëqyrjen mbi aktet dhe punën e organizatës në aspekt të dispozitave të këtij ligji, është Ministria e Kulturës.

NDARJA 1. Kontrolli nga organet e organizatës

Neni 154

(1) Organet kompetente të organizatës në pajtim me statutin, përkatësisht marrëveshjen për themelim mund, të kërkojnë:

1) raporte vjetore nga organet mbikëqyrëse dhe ekzekutive të organizatës për mjetet e grumbulluara, shpërndarjen e tyre, punën e organizatës dhe zbatimin e akteve për kompensime dhe realizimin e marrëveshjeve me shfrytëzuesit dhe me shoqatat e huaja përkatëse;

2) raportet e revizionit për gjendjen financiare së bashku me mendimin për rregulshmërinë e punës në pajtim me këtë ligj, aktet e përgjithshme të organizatës dhe marrëveshjet e lidhura dhe

3) propozime për planin financiar dhe shpenzimet për punën për vitin e ardhshëm.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk ndikojnë në obligimet e organizatës ndaj raporteve tjera financiare dhe revizioneve të ndërmarra në bazë të rregullave tjera.

NDARJA 2. Kontrolli nga bartësit e të drejtave

Neni 155

(1) Çdo bartës i të drejtave që i menaxhon organizata mundet në afatin e përcaktuar me statutin, përkatësisht me marrëveshjen për themelim, të realizojë inspektim në raportet financiare vjetore dhe raportin e organit mbikëqyrës të organizatës dhe të kërkojë raport me shkrim për mjetet e grumbulluara nga shfrytëzimi i veprave autoriale të tij, përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta. Organizata është e detyruar që raport të atillë t'i dorëzojë më së voni në afat prej tetë ditësh nga kërkesa.

(2) Së paku një e dhjeta nga bartësit nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të kërkojnë një ose më shumë persona profesionalë të jashtëm dhe të pavarur, që ta kontrollojnë punën e organizatës dhe të japin mendim profesional, i cili dorëzohet edhe në Ministrinë e Kulturës.

NDARJA 3. Mbikëqyrja nga organi shtetëror kompetent

Neni 156

(1) Ministria e Kulturës mundet në çdo kohë nga organizata të kërkojë informata ose të dhëna ose raporte për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj dhe të kryejë inspektim në aktet, raportin vjetor financiar, dokumentacionin financiar dhe tjetër.

(2) Organizata është e detyruar që ta njoftojë Ministrinë e Kulturës për fillimin dhe pushimin e funksioneve të personave udhëheqës dhe përfaqësuesve të organeve, për lidhje të marrëveshjeve të përgjithshme për shfrytëzimin e të drejtave, për lidhjen e marrëveshjeve me organizatat e huaja përkatëse, për ndryshime dhe plotësime të statutit, përkatësisht marrëveshjes për themelim, si dhe për çështje tjera të ngjashme.

(3) Për ndryshimin dhe plotësimin e statutit, përkatësisht marrëveshjes për themelim, nevojitet pëlqim nga Ministria e Kulturës. Nëse Ministria e Kulturës nuk prononcohet në afat prej 60 ditësh nga dorëzimi i akteve, konsiderohet se pëlqimi është dhënë.

Masat në bazë të mbikëqyrjes

Neni 157

(1) Nëse në zbatimin e mbikëqyrjes mbi aktet e organizatës Ministria e Kulturës vlerëson se akti i përgjithshëm ose i veçantë nuk është në pajtim me këtë ligj, statutin, përkatësisht marrëveshjen për themelim, me aktvendim do ta ndërprejë nga zbatimi dhe do të ngritë procedurë para gjykatës kompetente për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit.

(2) Nëse në zbatimin e mbikëqyrjes mbi punën e organizatës Ministria e Kulturës vlerëson se puna nuk është në pajtim me këtë ligj, me lejen, me statutin, përkatësisht me marrëveshjen për themelim ose aktet e përgjithshme për grumbullim dhe shpërndarje të kompensimeve, Ministria do të lëshojë aktvendim me të cilin së pari organizatës i bën vërejtje me shkrim dhe i përcakton afat të arsyeshëm prej së paku 30 ditësh për mënjanimin e parregullsive të konstatuara. Nëse në afatin e dhënë nuk mënjanohej parregullsitë e konstatuara, leja për menaxhim kolektiv do t'i hiqet.

(3) Kundër aktvendimit për heqjen nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të ngritet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

Ndarja 4. Transparenca në punë

Publikimi

Neni 158

Organizata është e detyruar që një herë në vit t'i publikojë raportet për punën dhe për kompensimet e grumbulluara nga shfrytëzimi i veprave, përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta të cilat në mënyrë kolektive i udhëheq përmes internetit dhe/ose përmes njërit prej medimeve të shtypit.

KREU I PESTË

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË AUTORIT DHE TË DREJTAVE TË PËRAFËRTA

PJESA 1.

DOSPOZITA TË PËRGJITHSHME

Llojet e mbrojtjes dhe zbatimi i rregullave tjera

Neni 159

(1) E drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta gëzojnë mbrojtje penale, civile dhe kundërvajtëse.

(2) Mbrojtja penale e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta realizohet sipas dispozitave të Kodit Penal dhe rregullave të procedurës penale.

(3) Mbrojtja civile e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta realizohet sipas rregullave për procedurë kontestimore, për sigurimin e kërkesave, për marrëdhëniet obliguese dhe këtij ligji.

(4) Mbrojtja kundërvajtëse e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta realizohet sipas rregullave për kundërvajtje dhe këtij ligji.

(5) Mbrojtja e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta e përfshin edhe mbrojtjen e masave teknologjike nga cenimi i të drejtave.

(6) Në procedurat me kërkesë për masa të përkohshme, të përcaktuara me këtë ligj, gjatë importit, eksportit ose eksportit të sërishëm të veprës autoriale, lëndës së të drejtës së përafërt apo ekzemplarit të tyre, zbatohen rregullat për masa doganore për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale.

Personi i autorizuar për mbrojtje

Neni 160

(1) Personi, e drejta e të cilit e përcaktuar me këtë ligj është cenuar, kur ekziston dyshim i arsyeshëm se do t'i cenohet e drejta dhe kur kanoset një kërcënim i vërtetë nga cenimi i të drejtave, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ka të drejtë që të parashtrojë:

1) kërkesë për mbrojtjen e të drejtës dhe

2) kërkesë për masa të përkohshme dhe masa të tjera, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Si person, sipas paragrafit (1) të këtij neni krahas autorit, konsiderohet edhe bartësi i të drejtës, personi i autorizuar që ta shfrytëzojë të drejtën dhe organizata (bartësit e të drejtës).

(3) Procedura për kërkesat paditëse nga paragrafi (1) i këtij neni është urgjente.

Solidariteti i palëve

Neni 161

(1) Kur një e drejtë e përcaktuar me këtë ligj është cenuar, secili nga bartësit e kësaj të drejte mundet që nga personi i tretë të kërkojë mbrojtje të së drejtës sikur të jetë bartës i vetëm. Kur personi që e ka cenuar të drejtën i plotëson kërkesat e njërit nga bartësit e së drejtës së njëjtë, obligimi i tij pushon edhe ndaj bartësve tjerë të së drejtës. Nëse bëhet fjalë për procedurë gjyqësore e cila është në vijim, bartësit e të drejtës së njëjtë konsiderohen për oponentë të vetëm.

(2) Kur ekzistojnë më shumë kryerës të cenimit të ndonjë të drejte nga ky ligj, secili prej tyre në mënyrë solidare përgjigjet për cenimin.

Mbrojtja e të drejtës që menaxhohet në mënyrë kolektive

Neni 162

Kur organizata do të dëshmojë se është kryer cenim i të drejtës së përcaktuar me këtë ligj, nuk nevojitet përcaktimi i cenimit nga ana e bartësit individual, e drejta e të cilit menaxhohet në mënyrë kolektive.

NDARJA 1. Mbrojtja e masave teknologjike

Nocioni dhe përmbajtja e masave teknologjike

Neni 163

(1) Masa teknologjike sipas këtij ligji, janë cilado qoftë teknologji, program kompjuterik, mjete ose pjesë të tyre përbërëse, të cilat gjatë punës së tyre të rregullt janë dedikuar për parandalimin dhe kufizimin e veprimeve për cenimin e të drejtës së përcaktuar me këtë ligj, pa leje të bartësit të së drejtës. Këto masa konsiderohen si të dobishme, nëse bartësi i të drejtës i realizon me zbatimin e qasjes së kontrolluar ose procesit të mbrojtjes, siç është kodimi, shtrembërimi ose ndonjë formë tjetër e ndryshimit të veprës, si dhe përmes mekanizmave për kontroll të shumëzimit.

(2) Konsiderohet se ndonjë person e cenon të drejtën ekskluzive, të përcaktuar me këtë ligj, kur e ka ditur ose ka mundur ta dijë se ndërmerr çfarëdo qoftë veprimesh kundërmbrojtëse, me qëllim të shpërdorimit të masave të dobishme teknologjike që shërbejnë për mbrojtje të asaj të drejte.

(3) Si cenim i të drejtave ekskluzive të përcaktuara me këtë ligj, konsiderohet edhe kur ndonjë person prodhon, importon me qëllim të lëshimit në qarkullim, lëshon në qarkullim, shet, huazon, reklamon për shitje ose huazim ose posedon për qëllime komerciale teknologji, programe kompjuterike, mjete ose pjesë të tyre përbërëse ose kryen shërbime në mënyrë të paautorizuar të cilado qoftë masave teknologjike, të cilat:

- 1) janë promovuar, reklamuar ose janë shitur për simulimin e masave teknologjike;
- 2) kanë vetëm qëllim ose shfrytëzim të kufizuar komercial, përveç për simulim dhe
- 3) parësisht janë krijuar, prodhuar, adaptuar ose funksionojnë që të mundësohet ose lehtësohet simulimi i masave teknologjike.

(4) Dispozitat e këtij neni, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe në cilëndo qoftë teknologji, program kompjuterik, mjete ose pjesë të tyre përbërëse me të cilat informatat elektronike për menaxhim me të drejtat janë mënjanuar ose ndryshuar.

Përgjashtime nga zbatimi i masave për mbrojtje teknologjike

Neni 164

(1) Bartësi i të drejtës që shfrytëzon masa teknologjike është i obliguar, që pa prolongime, në afat më të shkurtër të mundshëm, me kërkesë të personit i cili ka qasje ligjore në veprën autoriale, në rast të përjashtimeve dhe kufizimeve nga neni 52 paragrafi (1) pikat 2, 3, 4, 5 dhe 8 dhe nga neni 54 i këtij ligji, t'i mundësojë qasje dhe shfrytëzim të veprës përmes mënjanimit të masave teknologjike ose përmes sigurimit të mjeteve tjera përkatëse.

(2) Kushtet nga neni 51 i këtij ligji, në mënyrë përkatëse kanë të bëjnë me përjashtimet dhe kufizimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Përjashtimet dhe kufizimet sipas këtij neni, nuk kanë të bëjnë me të drejtën e vënies në disponim për publikun.

(4) Dispozitat nga marrëveshjet të cilat janë në kundërshtim me paragrafin (1) të këtij neni, janë të pavlefshme.

Mbrojta e informatave elektronike për menaxhim me të drejtat

Neni 165

(1) Konsiderohet se ndonjë person i cenon të drejtat materiale ekskluzive kur në mënyrë të vetëdijshme, pa leje e mënjanon ose ndryshon cilëndo qoftë informatë elektronike për menaxhim me të drejtat, si dhe shumëzon, lëshon në qarkullim, importon për lëshim në qarkullim, huazon ose publikisht kumton një të drejtë autoriale, ose lëndë të të drejtave të përafërta, informatat elektronike të të cilëve për menaxhim me të drejtat janë mënjanuar ose ndryshuara në mënyrë të paautorizuar, ndërsa e ka ditur ose ka mundur të dijë se me këtë shkakton, mundëson, lehtëson ose fsheh cenim të të drejtave.

(2) Informata elektronike për menaxhim me të drejtat nga paragrafi (1) i këtij neni, paraqesin të gjitha informatat që i sigurojnë bartësit e të drejtave, e me të cilat njihen të drejtat autoriale, përkatësisht lëndët e të drejtave të përafërta, duke i përfshirë edhe bazat e të dhënave si autorin, bartësit tjerë të të drejtave, afatet dhe kushtet për shfrytëzimin e tyre, si dhe numrat dhe kodet përkatëse të tyre, që i paraqesin ato informata.

PJESA 2

VEPRIMI PËR KËRKESËN PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE

Përmbajtja e mbrojtjes së të drejtës

Neni 166

E drejta e mbrojtjes nga neni 160 paragrafi (1) i këtij ligji, i përmban kërkesat në vijim për:

- 1) ndërprerjen e veprimit të cenimit;
- 2) kompensimin e dëmit material;
- 3) kompensimin e dëmit jomaterial;
- 4) kompensimin e rritur;
- 5) shënimin e autorit;
- 6) kthimin e përfitimeve të marra nga shfrytëzimi i palejuar;
- 7) mënjanimin nga qarkullimi të sendeve nga cenimi i të drejtës dhe
- 8) shpalljen e aktgjykimit gjyqësor.

Ndërprerja e veprimit të cenimit

Neni 167

Personi nga neni 160 i këtij ligji, mund të kërkojë nga i padituri ndërprerje të veprimit me të cilin cenohet e drejta, si dhe\ose ndalim të veprimit të tillë ose të ngjashëm në të ardhmen.

Kompensimi i dëmit material

Neni 168

Nëse me shkeljen e të drejtës nga ky ligj është bërë dëm material, personi nga neni 160 i këtij ligji ka të drejtë që të kërkojë kompensim për dëmin e bërë material dhe për fitimin e humbur. Kompensimi përcaktohet në shumë të cilën i padituri do ta paguante, nëse ka kërkuar shfrytëzim ligjor të së drejtës (kompensim të zakonshëm), përkatësisht në shumë të përcaktuar me tarifa përkatëse, përkatësisht me marrëveshje të përgjithshme.

Kompensimi për dëmin jomaterial

Neni 169

Gjatë cenimit të së drejtës morale dhe pavarësisht nga kompensimi i shqiptuar i rritur nga neni 170 i këtij ligji, dhe gjatë mosekzistimit të dëmit material, gjykata mund të shqiptojë gjykim që autorit t'i paguhet dëmshpërblim në para i drejtë për dhimbje shpirtërore të pësuar dhe vuajtje, si pasojë e cenimit të së drejtës morale, nëse përcakton se rrethanat e rastit dhe veçanërisht shkalla e cenimit dhe kohëzgjatja e saj e kanë shkaktuar atë.

Kompensimi i rritur

Neni 170

(1) Nëse e drejta e përcaktuar me këtë ligj është e cenuar me qëllim ose pakujdesi të skajshme, personi nga neni 160 i këtij ligji mund të kërkojë pagesë të kompensimit të kontraktuar ose të zakonshëm për këtë formë të shfrytëzimit, të rritur deri në 200%, pavarësisht nëse nga cenimi ka pësuar dëm pronësor (dënim civil).

(2) Gjatë vendimmarrjes për kërkesën për pagesë të kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni dhe matjes së shumës së saj, gjykata do t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, sidomos shkallën e fajit të të paditurit, shumën e kompensimit të kontraktuar ose të zakonshëm.

Shënimi i autorit

Neni 171

Gjatë cenimit të së drejtës morale për shënimin e emrit, pseudonimit ose ndonjë shenje tjetër të autorit gjatë shfrytëzimit të veprës, gjykata mund të gjykojë për shënimin e tyre plotësues, përkatësisht shënimin në mënyrë të drejtë.

Kthimi i përfitimeve të marra nga shfrytëzimi i palejuar

Neni 172

Kthimi i përfitimeve të marra nga shfrytëzimi i palejuar kryhet në pajtim me rregullat për marrëdhënie obliguese.

Largimi nga qarkullimi i i lëndëve nga cenimi i të drejtës

Neni 173

(1) Në rast të cenimit të së drejtës ekskluzive sipas këtij ligji, edhe pa ndikuar në kërkesat për kompensim të dëmit dhe pavarësisht nga shqiptimi i kompensimit nga cilado qoftë formë në pajtim me këtë ligj, personi nga neni 160 i këtij ligji ka të drejtë që të kërkojë:

1) largimin nga qarkullimi i ekzemplarëve të veprës autoriale dhe lëndëve të të drejtave të përafërta, të cilat pa leje janë përpunuar për lëshim në qarkullim ose janë në qarkullim, si dhe materialet dhe mjetet e shfrytëzuara ose dedikuara për cenimin dhe

2) zhdukjen e tyre.

(2) Masat nga paragrafi (1) i këtij neni, zbatohen me shpenzime të personit i cili i ka cenuar të drejtat nga ky ligj.

(3) Gjatë shqiptimit të masave nga paragrafi (1) i këtij neni, gjykata do t'i marrë parasysh rrethanat e rastit, veçanërisht përpjesëtimin ndërmjet seriozitetit të cenimit dhe kërkesave, interesin e personit nga paragrafi (1) i këtij neni për sigurimin e mbrojtjes efikase të të drejtave, si dhe interesat e personave të tretë.

(4) Dispozitat e këtij neni të cilat kanë të bëjnë me zhdukjen e veprave arkitektonike, zbatohen vetëm nëse ekziston shkak i arsyeshëm për këtë.

(5) Në rast kur masat e këtij neni nuk përputhen me natyrën dhe intensitetin e cenimit, e cila mund të shmanget në mënyrë tjetër, dhe nëse gjykata vlerëson se personi që e ka bërë cenimin ka vepruar pa qëllim dhe pa kujdes, gjykata mundet personit nga paragrafi (1) të këtij neni, nëse ai pajtohet, t'i përcaktojë pagesë të kompensimit në para në shumë e cila nuk mund të jetë më e vogël nga ajo e cila do ta fitonte gjatë shfrytëzimit të lejuar të së drejtës.

(6) Masat për zhdukje nga ky nen nuk mund të zbatohen, nëse me zhdukjen e mjeteve të shfrytëzuara ose të dedikuara për cenimin e të drejtës nga ky ligj do të shkaktohej dëm më i madh nga dëmi i shkaktuar nga cenimi i të drejtës, përveç kur bëhet fjalë për mjetet të cilat ekskluzivisht ose kryesisht janë dedikuar për cenimin.

(7) Kërkesat nga ky nen në lidhje me personat e tretë, parashkruhen në afat prej tre vitesh nga njoftimi nga personi nga neni 160 i këtij ligji për përpunimin e palejuar të lëndëve ose lëshimin e tyre në qarkullim, përkatësisht për dedikimin për lëshim në qarkullim, më së voni pesë vite nga përpunimi i tyre i palejuar, përkatësisht nga lëshimi në qarkullim.

Publikimi i aktgjykimit gjyqësor

Neni 174

Personi nga neni 160 i këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë që aktgjykimi i plotfuqishëm me të cilin në tërësi ose pjesërisht miratohet kërkesa e tij për mbrojtjen e të drejtës autoriale dhe të drejtave të përafërta, të publikohet në mediet për komunikim masiv, me shpenzime të të paditurit.

PJESA 3

MASA TË PÛRKOHËSHME PÛR MBROJTJEN E TÛ DREJTAVE

Përmbajtja e masave të përkohëshme

Neni 175

(1) Nëse personi nga neni 160 i këtij ligji parashtron kërkesë nga neni 160 paragrafi (1) pika 2 e këtij ligji, sipas rregullave për sigurimin e kërkesës (propozim ose padi) dhe bën cenim të së drejtës autoriale, ose kërcënohet rrezik nga cenimi, gjykata mund të shqiptojë masë të përkohëshme për ndërprerje ose pengim të cenimit, përkatësisht të urdhërojë:

1) pengimin e cenimit të drejtpërdrejtë të së drejtës;

2) përkohësisht ta ndalojë cenimin e së drejtës, ose ta kushtëzojë me pagesë të shumës në të holla në lartësi të dënimit të përcaktuar në të holla, përkatësisht gjobë për këtë lloj të cenimit të së drejtës, ose me parashtrimin e garancisë me të cilën do të sigurohet kompensim për këtë lloj të shfrytëzimit;

3) konfiskimin ose mosshpërndarjen e ekzemplarit për të cilin dyshon se e ka cenuar të drejtën për pengimin e të importit të tij dhe lëshim në qarkullim për qëllim komercial dhe

4) miratimin e masave tjera të ngjashme në pajtim me ligjin.

(2) Masën e përkohëshme nga paragrafi (1) i këtij neni, gjykata mund ta shqiptojë edhe kundër ndërmjetësuesit, shërbimet e të cilit shfrytëzohen për cenim të së drejtës.

(3) Në rast të cenimit të së drejtës për fitimin e dobisë ekonomike, dhe nëse personi nga paragrafi (1) i këtij neni siguron se nga cenimi i të drejtës i kërcënohet dëmi i pakompensueshëm, gjykata mund të shqiptojë masë për konfiskim të përkohëshëm të pronës së tundshme ose të patundshme, si dhe bllokim të llogarive bankare dhe mjeteve tjera të cenuesit të së drejtës. Për këtë qëllim, gjykata mund të urdhërojë bartje të dokumenteve bankare dhe financiare dhe qasje në informata. Gjukata është e obliguar që ta sigurojë ruajtjen e fshehtësisë së këtyre të dhënave, si dhe ta ndalojë keqpërdorimin e tyre.

(4) Masat e përkohëshme nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të shqiptohen edhe pa dëgjim të palës së kundërt, nëse kërkuesi i masave parashtron dëshmi të arsyeshme se ai është bartës i së drejtës, dëshmi se e drejta i është cenuar ose i kërcënohet cenimi ose prolongimi për bartësin e të drejtës do të shkaktohej dëm të pakompensueshëm. Nëse masa e përkohëshme është shqiptuar pa dëgjim të palës së kundërt, gjykata aktvendimin për masën e përkohëshme, menjëherë pas zbatimit të tij do t'ia dorëzojë asaj.

(5) Në aktvendimin për masë të përkohëshme, gjykata do ta përcaktojë edhe kohëzgjatjen e asaj mase. Nëse masa është përcaktuar para parashtrimit të padisë, aktvendimi duhet të përmbajë edhe afat në të cilin kërkuesi është i obliguar që të parashtrojë padi për shkak të arsytimit të masave të shqiptuara, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 20 ditë pune, duke llogaritur nga dita e dorëzimit të aktvendimit propozuesit të masës.

(6) Për procedurat për përcaktimin e masave të përkohëshme zbatohen rregullat për sigurimin e kërkesave, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.

Masat për sigurimin e dëshmive

Neni 176

(1) Për kërkesën nga neni 175 paragrafi (1) të këtij ligji, gjykata mund të përcaktojë masa për sigurimin e dëshmive.

(2) Masat nga paragrafi (1) i këtij neni, gjykata mund t'i shqiptojë veçanërisht për:

1) përpunimin e përshtimit të detajuar të ekzemplarit për të cilin dyshohet se e cenon të drejtën;

2) konfiskimin e ekzemplarit për të cilin dyshohet se e cenon të drejtën dhe

3) konfiskimin e materialeve dhe mjeteve të cilat janë të shfrytëzuara për përpunimin dhe lëshimin në qarkullim të ekzemplarit për të cilin dyshohet se e cenon të drejtën, si dhe dokumentacionit që ka të bëjë me të.

(3) Masat nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të shqiptohen edhe pa dëgjimin e palës së kundërt, nëse kërkuesi i masave parashtron dëshmi të arsyeshme se ai ose i autorizuari prej tij është bartës i të drejtës dhe dëshmi se e i është shkelur e drejta ose i kërcënohet cenimi, ose nëse prolongimi për bartësin e të drejtës do të shkaktojë dëm të pakompensueshëm. Nëse masa është e shqiptuar pa dëgjimin e palës së kundërt, gjykata aktvendimin për masën do t'ia dorëzojë menjëherë pas zbatimit të saj.

(4) Në aktvendim për masën, gjykata do të përcaktojë edhe kohëzgjatje të asaj mase. Nëse masa është e përcaktuar para parashtrimit të padisë, aktvendimi duhet të përmbajë edhe afat në të cilin kërkuesi është i obliguar që të parashtrojë padi për arsyetimin e masës së shqiptuar, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 20 ditë pune, duke llogaritur nga dita e dorëzimit të aktvendimit propozuesit të masës.

(5) Për procedurat për përcaktimin e masave për sigurimin e dëshmive do të zbatohen rregullat për sigurimin e kërkesave, nëse nuk është e përcaktuar ndryshe me këtë ligj.

Parashtrimi i dëshmive gjatë procedurës kontestimore

Neni 177

(1) Kur pala në procedurën kontestimore thirret në dëshmi dhe deklaron se ajo gjindet te pala e kundërt ose është nën kontroll të saj, gjykata do ta thërrasë palën e kundërt që ta parashtrojë atë dëshmi, duke përcaktuar edhe afat për veprim.

(2) Në rast kur bartësi i të drejtës nga ky ligj si paditës në padi, deklaron se ka ndodhur cenim i të drejtës për fitimin e dobisë ekonomike, si dhe kur në procedurë thirret në dokumente bankare, financiare dhe ekonomike, dokumente personale dhe dëshmi të ngjashme dhe deklaron se të njëjtat gjinden te pala e kundërt ose nën kontroll të saj, gjykata do ta thërrasë atë palë që t'i parashtrojë ato dëshmi, duke përcaktuar edhe afat për veprim.

(3) Kur pala e cila është thirrur që të parashtrojë dëshmi mohon se dëshmia gjendet tek ajo ose nën kontroll të saj, për vërtetimin e atyre fakteve, gjykata mund të nxjerrë dëshmi.

(4) Lidhur me të drejtën e palës që ta refuzojë parashtrimin e dëshmisë së kërkuar, zbatohet e drejta e refuzimit të dëshmimit sipas rregullave për procedurën kontestimore.

(5) Gjkata do të vlerësojë se çfarë rëndësie ka ajo që pala nuk do të veprojë sipas aktvendimit të gjykës, për parashtrimin e dëshmisë.

(6) Kundër aktvendimit të gjykatës nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nuk lejohet ankesë e veçantë.

PJESA 4 MASA TJERA

Dorëzimi i të dhënave

Neni 178

(1) Personi nga neni 160 i këtij ligji, i cili ka ngritur procedurë kontestimore për mbrojtjen e të drejtës, mund të kërkojë dorëzim të të dhënave për origjinën dhe kanalet e qarkullimit të veprës/ekzemplarit të veprës, me të cilat cenohet e drejta e tij.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të parashtrohet në formë të padisë ose të masës së përkohshme kundër personit, i cili:

1) është i paditur në procedurën kontestimore nga paragrafi 1 i këtij neni;

2) në kryerjen e veprimtarisë së vet komerciale posedon vepër/ekzemplar të veprës për të cilën dyshon se e cenon të drejtën;

3) në kryerjen e veprimtarisë së tij komerciale kryen shërbim për të cilin dyshohet se e cenon të drejtën ose kryen shërbime të cilat shfrytëzohen në veprimtari për të cilën dyshohet se e cenon të drejtën dhe

4) është shënuar si person i cili merr pjesë në prodhim ose qarkullim të veprës/ekzemplarit të veprës ose kryerje të shërbimeve për të cilat dyshohet se e cenon të drejtën, e është njëri nga personat nga paragrafi (2) pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

(3) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të parashtrohet si kërkesë e parë në padi me më shumë kërkesa paditëse, nëse personi kundër të cilit parashtrohet kërkesa është i paditur edhe në padinë kryesore.

(4) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të përfshijë veçanërisht të dhëna për:

1) emrat dhe adresat e prodhuesve dhe distribuesve, furnizuesve dhe poseduesve paraprakë të mallrave, përkatësisht dhënësve të shërbimeve, si dhe shitësve me shumicë dhe pakicë për të cilët vepra/ekzemplari është dedikuar dhe

2) sasinë e veprave/ekzemplarëve të veprave të prodhuara, të përpunuara, të dërguara, të porositura, si dhe për çmimet e tyre.

(5) Personi për të cilin është parashtruar kërkesa për dorëzimin e të dhënave të këtij neni, mund ta refuzojë dorëzimin e atyre të dhënave nga të njëjtat arsye prej të cilave, sipas rregullave nga Ligji për procedurë kontestimore, mund të refuzohet dëshmimi. Nëse e refuzon dorëzimin e të dhënave pa shkak të arsyeshëm, përgjigjet për dëmin në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhënie obliguese.

(6) Dispozitat e këtij neni nuk ndikojnë në rregullat për mënyrën e shfrytëzimit të informatave të besueshme në procedurë civile, kundërvajtëse ose penale, të rregullave me të cilat rregullohet përgjegjësia për keqpërdorimin e të drejtave për marrjen e të dhënave, si dhe të dispozitave me të cilat rregullohet përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale.

(7) Dispozitat e këtij neni, nuk e pengojnë zbatimin e dispozitave për masat e përkohëshme dhe për masat për sigurimin e dëshmive të këtij ligji.

Veprimet preventive për mbrojtje

Neni 179

Për sigurimin e dëshmive ose për arsye tjera autori, përkatësisht bartësi i të drejtës sipas këtij ligji, mund të regjistrojë dhe depozitojë origjinale ose ekzemplarë të veprës së tij, fonogram, videogram ose lëndë nga ndonjë e drejtë tjetër e tij te noteri ose përfaqësuesi ligjor.

Simbolet dhe shenjat

Neni 180

(1) Bartësi i të drejtës autoriale ekskluzive nga ky ligj, mund t'i shënojë origjinalin ose ekzemplarët nga vepra e tij, përkatësisht videogramin, me shenjë © para emrit të tij, pseudonimit ose shenjës dhe vitit të botimit të parë.

(2) Bartësi i të drejtës ekskluzive të fonogramit sipas këtij ligji, mund t'i shënojë origjinalin ose ekzemplarët e fonogramit të tij të publikua, ose mbështjellëset me shenjën e para emrit të tij, pseudonimit ose shenjës dhe vitit të publikimit të parë.

(3) Nëse nuk dëshmohet e kundërta, konsiderohet se të drejtat ekskluzive të veprave, përkatësisht fonogrameve, i përkasin personit të shënuar në pajtim me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(4) Dispozitat e këtij neni nuk ndikojnë dhe nuk e pengojnë realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të përcaktuara me këtë ligj.

PJESA 5 MBIKËQYRJA

Organi kompetent

Neni 181

Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji për organizatat për menaxhim kolektiv e kryen Ministria e Kulturës.

PJESA 6 SANKSIONET KUNDËRVAJTËSE DHE MASAT

Gjoba për personin juridik

Neni 182

(1) Gjorbë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, i cili:

1) në mënyrë jodinjtoze e shfrytëzon krijimtarinë popullore dhe nuk e shënon burimin dhe origjinën (neni 53 paragrafi (2));

2) pa prolongim nuk e njofton organizatën përkatëse për menaxhim kolektiv, për çdo ndryshim të rrethanave për shfrytëzimin ose për ndërprerjen e saj (neni 135 paragrafi (5));

3) nuk e njofton dhe nuk dorëzon informata, dokumente dhe të dhëna, nuk i paguan shumë përkatëse të kompensimeve organizatës përkatëse për menaxhim kolektiv në afate të përcaktuara dhe nuk mundëson inspektim në dokumentacion (neni 135 paragrafët (1), (2), (3) dhe (4)) dhe

4) nuk mundëson qasje dhe shfrytëzim të veprës përmes mënjanimi të masave teknologjike ose mjeteve tjera për personin i cili ka qasje ligjore në rast të përjashtimeve dhe kufizimeve të së drejtës, të përcaktuara në Kapitullin e Dytë Pjesa 4. të këtij ligji (neni 164).

(2) Gjorbë në shumë prej 250 deri në 600 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni dhe personit përgjegjës në personin juridik.

Gjoba për tregtarin individual ose individin i cili kryen veprimtari ose profesion të pavarur

Neni 183

Gjorbë në shumë prej 250 deri në 600 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga neni 182 paragrafi (1) i këtij ligji, tregtarit individual dhe individit i cili kryen veprimtari ose profesion të pavarur.

Gjoba për personin fizik

Neni 184

Gjorbë në shumë prej 150 deri në 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga neni 182 paragrafi (1) i këtij ligji, personit fizik.

Të hyrat buxhetore

Neni 185

Gjobat nga ky nen paraqesin të hyra në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

Ndalimi për ushtrimin e veprimtarisë së veçantë, profesionit apo detyrës

Neni 186

Për kundërvajtjen nga neni 182 paragrafi (1) i këtij ligji, personit juridik nga neni 182, tregtarit individual dhe individit i cili kryen veprimtari ose profesion të pavarur nga neni 183 dhe personit fizik nga neni 184 i këtij ligji, mund t'i shqiptohet edhe ndalim për kryerjen e veprimtarisë së veçantë, profesionit apo detyrës në kohëzgjatje prej së paku një viti deri në më së shumti dy vjet, duke llogaritur nga dita e plotëfuqisë së vendimit.

Afatet për parashkrim dhe zbatim

Neni 187

Për kundërvajtjet nga neni 182 paragrafi (1) i këtij ligji nuk mund të ngritet procedurë, as ajo të udhëhiqet nëse kalojnë dy vjet nga dita kur është kryer kundërvajtja, kurse dënimi i shqiptuar për shkak të kundërvajtjes së kryer nuk mund të zbatohet pas kalimit të dy viteve nga dita e plotëfuqishmërisë së vendimit për kundërvajtjen.

KAPITULLI I GJASHTË VLEFSHMËRIA E LIGJIT

Dispozita të përgjithshme

Neni 188

(1) Ky ligj vlen për të gjitha veprat autoriale dhe lëndët e të drejtave të përafërta të cilat në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë gëzuar mbrojtje juridike sipas Ligjit për të drejtën autoriale dhe të drejtat e përafërta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 47/96, 3/98, 98/2002, 4/2005 dhe 131/2007).

(2) Mbrojtje sipas këtij ligji gëzojnë autorët dhe bartësit e të drejtave të përafërta të cilët janë shtetas të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht e kanë selinë e tyre në Republikën e Maqedonisë.

(3) Autorë të huaj dhe bartës të huaj të drejtave të përafërta gëzojnë mbrojtje të njëjtë si edhe personat nga paragrafi (2) i këtij neni, në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

(4) Autorët e huaj dhe bartësit e huaj të të drejtave të përafërta të cilët gëzojnë mbrojtje në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, gëzojnë mbrojtje sipas neneve nga 189 deri në 195 të këtij ligji.

(5) Autorët e huaj dhe bartësit e huaj të të drejtave të përafërta të cilën nuk gëzojnë mbrojtje nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, mund të gëzojnë mbrojtje të njëjtë, si edhe personat nga paragrafi (2) i këtij neni në bazë të reciprocitetit faktik.

(6) Pavarësisht nga dispozitat tjera të këtij Kapitulli të këtij ligji, të huajt gëzojnë mbrojtje sipas këtij ligji lidhur me të drejtat morale në të gjitha rastet, kurse në lidhje me të drejtën e trashëgimisë dhe bazave të të dhënave si të drejta të përafërta, me kusht të reciprocitetit faktik.

(7) Reciprocitetin e dëshmon ai i cili thirret në të.

Autorët dhe veprat autoriale

Neni 189

(1) Mbrojtje sipas këtij ligji gëzojnë:

1) autori i huaj i cili ka vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë;

2) vepra e cila për herë të parë është botuar në Republikën e Maqedonisë, ose është botuar në Republikën e Maqedonisë në afat prej 30 ditëve nga dita kur për herë të parë është botuar në shtet tjetër;

3) vepra audiovizuele, producenti i së cilës ka selinë e vet ose vendqëndrimin në Republikën e Maqedonisë dhe

4) vepra arkitektonike ose figurative, e cila si patundshmëri, përkatësisht pjesë e saj përbërëse, gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Nëse veprën autoriale e kanë krijuar më shumë autorë, mbrojtje sipas këtij ligji gëzojnë të gjithë autorët, nëse së paku një nga ata i plotëson njërin nga kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Realizuesit dhe veprat

Neni 190

(1) Mbrojtje sipas këtij ligji gëzojnë artistët e huaj realizues:

1) të cilët kanë vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë;

2) veprat e të cilëve realizohen në territorin e Republikës së Maqedonisë;

3) veprat e të cilëve janë të incizuara në fonograme, që gëzojnë mbrojtje sipas këtij ligji dhe

4) veprat e të cilëve janë të inkorporuara në emitimin radiodifuziv përmes radios, por jo me qëllim që të incizohen në fonograme, që gëzojnë mbrojtje sipas këtij ligji.

(2) Nëse në shfaqje marrin pjesë më shumë realizues, mbrojtje sipas këtij ligji gëzojnë të gjithë, nëse së paku një prej tyre është shtetas i Republikës së Maqedonisë ose ka vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë.

Prodhuesit dhe botuesit

Neni 191

(1) Mbrojtje sipas këtij ligji, gëzojnë prodhuesit e huaj të fonogrameve dhe producentët filmikë, fonogrami ose videogrami i të cilëve është për herë të parë i incizuar në Republikën e Maqedonisë.

(2) Mbrojtje, sipas këtij ligji gëzon botuesi i huaj lidhur me të drejtat e tij, nëse botimi ka qenë për herë të parë i botuar në Republikën e Maqedonisë ose ka qenë i botuar në Republikën e Maqedonisë, në afat prej 30 ditëve nga dita kur për herë të parë është botuar në shtetin tjetër.

Organizata radiotelevizive

Neni 192

Mbrojtje, sipas këtij ligji, gëzon organizata e huaj radiotelevizive që i transmeton programet e veta, përkatësisht serviset radiodifuzive përmes transmetuesve që gjenden në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Zbatimi i afateve të kohëzgjatjes

Neni 193

Në vëllimin e zbatimit të obligimeve ndërkombëtare, për bartësit e huaj të të drejtave autoriale dhe drejtave të përafërta, të cilët gëzojnë mbrojtje sipas këtij ligji, vlejné afatet për kohëzgjatjen e atyre të drejtave në pajtim me këtë ligji, ndërsa skadojnë më së voni deri ditën kur zgjat mbrojtja në shtetin shtetas të të cilit janë, ose në të cilin kanë seli, por jo më gjatë se afatet e përcaktuara me këtë ligj.

Kumtimi publik nëpërmjet satelitit

Neni 194

(1) Mbrojtje, sipas këtij ligji, gëzon autori i huaj dhe bartësi i huaj i të drejtave të përafërta, vepra e të cilit, shfaqja ose lënda e të drejtës së përafërt është publikisht e kumtuar në Republikën e Maqedonisë nëpërmjet satelitit, nëse sinjalet satelitore përkatëse në zinxhir të pandërprerë komunikues që çon deri te sateliti dhe poshtë deri në tokë, janë futur në Republikën e Maqedonisë dhe dërguar nga Republika e Maqedonisë nën kontroll dhe përgjegjësi të organizatës radiotelevizive.

(2) Mbrojtje, sipas këtij ligji, realizohet pavarësisht nëse është plotësuar kushti nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse:

1) në Republikën e Maqedonisë gjendet stacion pranues-emitues, nga i cili transmetohen sinjalet programore ose

2) organizata e RTV-së e cila ka porositur emitim përmes satelitit është me seli në Republikën e Maqedonisë.

Personat pa shtetësi dhe refugjatët

Neni 195

(1) Autorët dhe bartësit e të drejtave të përafërta, të cilët nuk kanë shtetësi ose shtetësia e të cilëve nuk mund të përcaktohet-apatridë, gëzojnë mbrojtje të barabartë sipas këtij ligji, si dhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë, nëse kanë vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë.

(2) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni të cilët nuk kanë vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë ose nëse kjo nuk mund të përcaktohet, por kanë strehim të domosdoshëm në Republikën e Maqedonisë, gëzojnë mbrojtje të barabartë si shtetasit e Republikës së Maqedonisë.

(3) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni të cilët nuk kanë vendqëndrim as strehim të domosdoshëm në Republikën e Maqedonisë, në Republikën e Maqedonisë gëzojnë mbrojtje të barabartë sikur shtetasit e shtetit në të cilin kanë vendqëndrim ose strehim të domosdoshëm.

(4) Dispozitat e këtij neni kanë të bëjnë edhe me autorët e huaj dhe bartësin e huaj të të drejtave të përafërta, të cilët sipas rregullave të Republikës së Maqedonisë, e kanë statusin e refugjatit.

KAPITULLI I SHTATË

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Vlefshmëria e marrëveshjeve para këtij ligji

Neni 196

Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me marrëveshjet për shfrytëzimin e të drejtës autoriale ose të drejtës së përafërt ndërmjet bartësit dhe shfrytëzuesit të së drejtës që kanë qenë të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Veprimi i shoqatave për realizim kolektiv

Neni 197

Shoqata për realizim kolektiv të të drejtave autoriale dhe drejtave të përafërta të cilat kanë leje për realizimin kolektiv dhe pëlqime për aktet e përgjithshme për grumbullimin dhe shpërndarjen e kompensimeve, kanë të drejtë që ta vazhdojnë punën sipas dispozitave të Ligji për të drejtën autoriale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 47/96, 3/98, 98/2002, 4/2005 dhe 131/2007) deri në marrjen e lejes për menaxhim kolektiv sipas dispozitave të këtij ligji, por më së voni një vit nga hyrja e tij në fuqi.

Ndërprerja e procedurave për anulimin e lejeve

Neni 198

(1) Shoqatave për realizim kolektiv të së drejtës autoriale dhe të drejtave të përafërta të cilat deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji u janë dhënë leje për punë, ndërsa nuk u janë dhënë pëlqime për aktet e përgjithshme (për kompensime për shfrytëzimin e drejtës autoriale dhe drejtave të përafërta dhe për shpërndarjen e kompensimeve) e për këtë edhe nuk e kanë filluar punën, procedurat u ndërpriten, ndërsa lejet e lëshuara u anulohen.

(2) Shoqatat nga paragrafi (1) i këtij neni kanë të drejtë që të parashtrojnë kërkesë për marrjen e lejes për menaxhim kolektiv, sipas dispozitave të këtij ligji.

Ndërprerja e vlefshmërisë

Neni 199

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji për të drejta autoriale dhe të drejta të përafërta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nuër 47/96, 3/98, 98/2002, 4/2005 dhe 131/2007).

Zbatimi i prolonguar

Neni 200

Dispozitat për të drejtën e kompensimit nga shumëzimi për kopjim privat nga nenet 46, 47, 48 dhe 131 pikat 7, 8 dhe 9 të këtij ligji dhe për të drejtën e kompensimit të shërbimit publik nga nenet 50 dhe 131 pika 3 të këtij ligji, do të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Hyrja në fuqi

Neni 201

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".